

## ANKIM

- ANKUES:** **Arbër ÇEKAJ**, i biri i Selim dhe Feride, i datëlindjes 05.04.1980, lindur në Bajram Curri dhe banues në Njësinë Bashkiake Nr.2 Sauk Tiranë, **i përfaqësuar nga Av. Maksim HAXHI, avokat pranë zyrës së avokatisë “HAXHIA &HAJDARI”**, me Nr. NIPT. K81317053M, me adresë Bly “Dëshmorët e Kombit”,Nd.6, H.11, Ap.21, Njësia Administrative nr. 5.
- OBJEKTI:** Kundërshtimin e vendimit Nr..., datë 15.9.2020 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- Kërkojmë ndryshimin e vendimit Nr..., datë 15.9.2020 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duke u vendosur deklarimi i pafajshëm i shtetasit Arbër ÇEKAJ.
- ORGANI AKUZËS:** Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
- I AKUZUAR:** I akuzuar për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i narkotikëve”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar përkatësisht nga nenet 283/a/1, 333/a/1, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal.
- BAZA LIGJORE:** Neni 407, 410, 412, 415, 422, 428/b të Kodit të Procedurës Penale.

## GJYKATA E POSACME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

**Të Nderuar Anëtarë të Trupit Gjykses,**

Në lidhje me vendimin Nr..., datë 15.9.2020 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar po paraqesim përpara Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, faktet, argumentet dhe arsyetimin ligjor pse vendimi Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duhet ndryshuar duke shprehur edhe rezerva ligjore

për shtimin e shkaqeve ligjore të ankimit pasi të jemi njohur me vendimin e arsyetuar të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

## I. RRETHANAT E FAKTEVE

### 1.1 Me vendimin Nr.. datë 15.9.2020 Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka vendosur:

- Deklarimin e fajtorë të të pandehurit Arbër ÇEKAJ për kryerjen e veprës penale “Grupi strukturuar kriminal” parashikuar nga neni 333/a/1 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me pesë vjet burgim.
- Deklarimin e fajtorë të të pandehurit Arbër ÇEKAJ për kryerjen e veprës penale “Trafikimi narkotikëve” kryer në bashkëpunim në formën e grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 283/a/1 dhe 28/4 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me tetëmbëdhjetë vjet burgim.
- Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal dënimin e Arbër ÇEKAJ me njëzet e një vite burg. Në bazë të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e dënimit dhe dënohet me katërmëdhjetë vite burgim.

1.2 Më datë 27.05.2019, Prokuroria pranë Gjykatës për Krime të Rënda Tiranë ka depozituar kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq ndaj të pandehurve Arbër ÇEKAJ, Donald LUSHAJ dhe Armando PEZAKU, *me akuzat për kryerjen e veprave penale “Trafikimi i narkotikëve”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar përkatësisht nga nenet 283/a/1, 333/a/1, në lidhje me nenet 28/4 dhe 334/1 të Kodit Penal.*

1.3 Me vendimin e datës 24.06.2019, Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit Ervin Kondili për dërgimin e çështjes në gjyq ndaj të pandehurve Arbër ÇEKAJ, Donald LUSHAJ dhe Armando PEZAKU.

1.4 Më datë 27.02.2018, policia gjyqësore ka marrë njoftim nga përgjegjësi i njësisë së kontejnerëve, i cili është dhe doganier në terminalin e kontejnerëve me banane, pasi kishte dalë me shenjë “RED” (risk i lartë).

1.5 Kontejneri ndodhej i vendosur në trailerin me tagra DR3819E me Nr. GESU9449548, i cili do të transportohej me trajlerin e kompanisë Pelikan Transport.

1.6 Pasi ka përfunduar shkarkimi i bananeve nga kontejneri, është bërë fillimisht kontrolli me qen, i bananeve dhe i kontejnerit. Më pas është konstatuar se në krahun e djathtë të kontejnerit kishte një ndërhyrje dhe në pjesën e llamarinës anësore ishte hapur paksa, si

dhe dukeshin gjurmë të silikonit.

- 1.7 Në këto kushte është bërë një ndërhyrje në mesin e kontejnerit me trapano, duke bërë një vrimë. Nga kjo vrimë është konstatuar se ka dalë një material i bardhë, i cili për nga ngjyra, era dhe karakteristika ngjasonte me lëndën narkotike kokainë.
- 1.8 Në vazhdim me vendim të organit të Prokurorisë është vendosur lejimi i kontrolluar i kontejnerit për të dalë nga Porti i Durrësit. Pasi kontejneri është larguar nga porti ka vazhduar rrugën për në destinacionin ku ishte porositur malli banane për shoqërinë “Arbi Garden”.
- 1.9 Disa momente pas mbërritjes së kamionit në magazinat e shoqërisë “Arbi Garden”, pa u shkarkuar akoma bananet nga kontejneri është ndërhyrë nga ana e punonjësve të policisë duke pretenduar arrestimin në flagrancë të shtetasit Donaldo LUSHAJ.
- 1.10 Nga kontrolli në dyshemenë e kontejnerit janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provave materiale 528 pako të mbështjella me natriban dhe me ngjyre jeshile, të cilat brenda tyre kanë pasur një sasi lende e ngurtë, ngjyre si ajo e bardhë, që për nga era dhe karakteristikat ngjason me lëndën narkotike kokaine.
- 1.11 Në lidhje me mënyrën e porositjes së mallit banane nga ana e shoqërisë “Arbri Garden” nga Kolumbia për në Shqipëri sqarojmë mënyrën dhe procedurën që ndiqet, fakt ky i pa hetuar nga ana e organit të akuzës.
- 1.12 Rezulton nga provat shkresore por edhe nga pohimi i vetë organit të akuzës që shoqëria “Arbri Garden” ka marrëdhënie tregtare me shoqërinë Baccota në Kolumbi për blerjen e mallit banane. Midis shoqërisë Arbri Garden dhe shoqërisë Baccota është lidhur një kontratë vjetore për 52 javët e vitit për 2160 arka banane në javë.
- 1.13 Pasi lidhet kontrata me eksportuesin, shoqëria “Arbri Garden” edhe eksportuesi kontaktojnë me kompanitë të ndryshme detare që ofrojnë këtë shërbim nga porti i caktuar tek eksportuesi. Pasi vlerësohen ofertat më të mira në çmim, vendoset se me cilën prej kompanive do të lidhet kontrata për transportin detar e tokësor, sepse përveç çmimit është e rëndësishme edhe kohëzgjatja e tranzitit, por edhe a ka hapësirë në anije për të gjitha javët e vitit, **ngaqë kontrata e furnizimit është për çdo javë.**
- 1.14 Pasi është rënë dakord për të gjitha detajet e mësipërme, eksportuesi shoqëria Baccota dërgon me anë të e-mailit faturën për javën 01 me çmimin dhe arkat që është rënë dakord midis shoqërisë Arbri Garden dhe shoqërisë Baccota. **Në këtë moment paguhet 50% e faturës paradhënie për javën 01 (sipas klauzolës që përcakton pagesa në faturë) në mënyrë që të bëhet dërgesa e frutave.**
- 1.15 Një javë pasi janë nisur frutat e javës 01, eksportuesi shoqëria Baccota **i dërgon me e-mail shoqërisë Arbri Garden Bill of Ladding dhe certifikata origjine e fitosanitare të javës 01 dhe faturën për javën 02. Në këtë moment shoqëria Arbri**

- Garden realizon pagesën 50% final për javën 01 dhe 50% paradhënie për javën 02 e kështu me rradhë ndodh për të gjitha javët në vazhdim.**
- 1.16 **Theksojmë se, nga nisja e frutave deri në mbërritjen kalojnë të paktën 4 javë, d.m.th. deri sa të mbërrijnë frutat e javës 01 në portin e Durrësit, janë nisur e janë në det edhe java 02, 03, 04. Kur të mbërrijë java 04, janë nisur e janë në det javët 04, 06, 07. Mbase është bërë pagesa e plotë për javën 01, eksportuesi shoqëria Baccota nis me postë dokumentet origjinale *Bill of Lading*, çertifikata fitosanitare e origjine.**
- 1.17 Kur mbërrin java 01 në portin e Durrësit, kompania e transportit detar CMA CMG i dërgon me anë të e-mailit njoftim-mbërritjen dhe faturat për transportin detar e tokësor që duhet të paguajë shoqëria Arbri Garden për mbërritjen e mallit deri në magazinat e shoqërisë.
- 1.18 Pasi shoqëria Arbri Garden paguan faturat e transportit detar e tokësor nëpërmjet bankës, i dërgon *Seift Code* kompanisë së transportit detar CMA CMG-së. Agjentët e kompanisë së transportit detar këtu në Shqipëri CMA CGM ALBANIA kontaktojnë me agjentët e kompanisë së transportit detar CMA CGM Kolumbi, vendi ku janë nisur frutat, për të marrë urdhër-lirimin e frutave, nga eksportuesi i frutave. Pasi paguhet doganën, AKU, skanimin e agjentin doganor nga ana e shoqërisë Arbri Garden, (këto paguhet për çdo ngarkesë), Agjenti Doganor (Arlind Madani) në port, mund të vazhdojë me procedurat e zhdoganimit. Pasi kanë mbaruar të gjitha procedurat e zhdoganimit, kompania e transportit detar CMA CGM ALBANIA dërgon frutat në ambientet e shoqërisë Arbri Garden.
- 1.19 **Pasi vjen kamioni i kompanisë detare, kur për transportin tokësor është shoqëria Pelikani e cila është edhe aksionare me 60% të kuotave në shoqërinë CMA CGM ALBANIA. Punëtorët e shoqërisë Arbri Garden shkarkojnë frutat dhe kamioni bashkë me kontejnerin pa fruta, largohen nga magazinat e shoqërisë Arbri Garden dhe shkarkimi i frutave zgjat 30 deri në 50 minuta maksimumi.**
- 1.20 **Për rastin konkret rezulton se shoqëria Arbri Garden ka porositur 2160 arka banane për javën 02. Shoqëria eksportuesi Baccota në këtë rast, i ka dërguar faturën për 2160 arka për javën 02 shoqërisë Arbri Garden, e cila ka bërë pagesën 50% final për javën 01 dhe 50% paradhënie për javën 02.**
- 1.21 **Në këtë kohë janë nisur frutat e javës 02. Një javë më pas (03) shoqëria Baccota ka dërguar me e-mail *Bill of Lading* dhe çertifikatat e origjinës dhe fitosanitare për javën e 02. Pasi është bërë pagesa e plotë për javën 02 e paradhënie për javën 03 nga ana e shoqërisë Arbri Garden, shoqëria Baccota i ka nisur me postë dokumentet origjinale, *Bill of Lading* dhe Çertifikatat Origjine e Fitosanitare.**
- 1.22 **Theksojmë se, çdo ngarkesë që niset nga eksportuesi shoqëria Baccota,**

- kontrollohet nga autoritetet portuale atje në bashkëpunim me autoritetet dhe për këtë shërbim të ofruar, shoqëria Baccota paguan 0.15 cent për çdo arkë.** Ky fakt i është bërë të ditur shoqërisë Arbri Garden nga ana e shoqërisë Baccota (çmim i cili i llogaritet Arbri Garden në çmimin total të mallit banane).
- 1.23 Ky çmim dhe procedure ndiqej për të gjitha firmat eksportuese të frutave atje pa dallim se në cilin vend eksportoheshin. Pra është e njëjta procedurë që ndiqet edhe në portin e Durrësit si në hyrje edhe në dalje.
- 1.24 **I pandehuri Arbër Çekaj është njoftuar me e-mail nga kompania e transportit detar e tokësor CMA-CGM, se ngarkesa e javës 02 ishte ndaluar për inspektim total, të plotë në Livorno të Italisë. Mbasij janë inspektuar malli dhe kontenierët, shoqëria CMA-CGM i ka dërguar me e-mail shoqërisë Arbri Garden faturën për inspektimin e realizuar në vlerën 7500 Euro.**
- 1.25 Menjëherë pas këtij njoftimi, i pandehuri Arbër ÇEKAJ ka kontaktuar me Ermir MALIQATIN, administratorin e shoqërisë CMA-CGM ALBANIA për të pyetur se çfarë është kjo tarifë e çmendur.
- 1.26 Nga ana e Ermir MALIQATIT i është thënë që ai do të kontrollonte me agjentët e shoqërisë CMA-CGM në Itali dhe i ka thënë se porti i Livornos i ka tarifatat super të çmendura dhe do t'i duhet të negocionte por që nuk e vendoste ai.
- 1.27 Nga ana e Arbër ÇEKAJ për shkak të çmimit shumë të lartë të vendosur për inspektimin në Livorno i ka komunikuar Ermir MALIQATIT faktin që do t'i linte frutat e nuk do t'i merrte. Ermir MALIQATI i ka thënë se nëse nuk i merr frutat, CMA-CGM-ja do ta fuste në *Black List (listen e zezë të klientëve)*, fakt që do të thoshte se shoqëria Arbri Garden unë do të kishte më të drejtën për të ngarkuar me shoqërinë CMA-CGM dhe nuk do të kishte mundësin që të merrte as frutat e 4 javëve në vazhdim, që tashmë ishin në nisur dhe ishin në det.
- 1.28 Nëse nga ana e shoqërisë Arbri Garden do të linte frutat i binte që të humbiste rreth 80 mijë USD që ishin paguar për blerjen e mallit banane. Për këtë arsye Arbër ÇEKAJ vendosi të negocionte me shoqërinë CMA-CGM në Shqipëri. Pasi ezauroi të gjithë mundësitë këtu dhe nuk pati sukses, Arbër ÇEKAJ i është drejtuar duke komunikuar me anë të e-mail-it me shoqërinë CMA-CGM në Marsejë, veprim i njëjtë është kryer edhe shoqëria Baccota të cilët komunikuan nga ana e vet me shoqërinë CMA-CGM-në, ku në përfundim është caktuar një takim në Panairin e përvitshëm të frutave në Berlin. Në këtë Panair Arbër ÇEKAJ merr pjesë rregullisht që kur ka nisur biznesin e frutave.
- 1.29 **Pas negociatave me CMA-CGM-në në Berlin, është rënë dakord që të paguhej 4100 Euro për inspektimin e kryer në Livorno dhe ata i premtojnë Arbër ÇEKAJ se do të bënin ulje prej 100 USD për ngarkesë për vitin në vazhdim.**

- 1.30 Edhe pse tarifa 4100 euro ishte jo normale sipas plan biznesit për aktivitetin e shoqërisë Arbri Garden, në fund duke vlerësuar aktivitetin tregtar, ishte më mirë që Arbër ÇEKAJ të paguante tarifën prej 4100 Euro, edhe pse jo e drejtë, pasi në rast të mos pagesës shoqëria Arbri Garden do të futej në Listën e Zezë dhe do të humbiste 80 mijë USD, plus që do të humbiste të gjithë klientët. Pra edhe nga llogaritja e plan biznesit rezultonte që rruga më e mirë për biznesin dhe aktivitetin e shoqërisë Arbri Garden ishte detyrimi për të paguar vlerën 4100 Euro, duke shpëtuar 76 mijë USD nga humbja e sigurt edhe gjithashtu edhe klientëve. Transporti do të vononte 4 javë dhe shoqëria Arbri Garden nuk kishte mundësi tjetër ku të merrte fruta për ti zëvendësuar.

## II. DEKLARIMI I DHËNË NGA I PANDEHURI ARMANDO PEZAKU

- 2.1 Në deklarin e tij shtetasi nën hetim Armando PEZAKU shpjegon se: Tek shoqëria “Pelikan” kam filluar punë rreth 6 muaj përpara se të arrestohesha. Më përpara kam punuar punë të ndryshme në fshat pasi nuk kam punuar si i siguruar. Unë zakonisht shkoj në punë rreth orës 07:50. Unë shkoj tek parku i kamionëve të firmës “Pelikan”, në Xhafzotaj, kontrollojë kamionin për gjendjen teknike dhe qëndroj aty dhe pres telefonatën e punonjësit tjetër kompanisë të cilin e njoh me emrin Semi, pasi ai më njoftonte për lëvizjet apo transportin që do të kryeja. Semi qëndronte në zyrat e shoqërisë “Pelikani” tek Porti i Durrësit. Në rast se nuk na njoftonte, qëndroja deri në orën 12:00 dhe më pas largohesha në shtëpi dhe të nesërmen shkoja përsëri në punë si zakonisht. Shoferët zakonisht qëndrojnë tek parku i kamionëve në Xhafzotaj dhe Spitallë dhe kur njoftonte me telefon Semi, shoferi merrte kamionin dhe shkonte sipas porosisë të Semit. Unë paguhesha në bazë të rrugëve të transportit që kryeja dhe zakonisht në atë periudhë që kam punuar, unë maksimumi kam kryer dy rrugë në ditë. Në rastet e transportit të kontejnerve, unë merja kamionin dhe shkoja tek porti, merja letrat tek zyra e shoqërisë “Pelikani” dhe më pas me letrat shkoja tek trau i kontejnerve, ku dorëzoja letrat dhe aty më jepnin një letër të vogël ku shënohej nr i kontejnerit dhe vendi ku ndodhet ai dhe për vincin për të ngarkuar atë. Më pas shkoja tek dogana dhe dorëzoja letrat dhe pasi kryeja procedurat e tyre ata më japin një letër dhe nëse del për të shkuar në skaner ata më njoftojnë për të shkuar për kontroll në skaner, në të kundërt vazhdoj ose tek dogana e Tiranës ose në destinacion në rast se është zhdoganuar aty më parë. Në rast se kontejneri është zhdoganuar aty në port marr letrat nga dogana, i dorëzoj tek trari në dalje dhe vazhdoj në destinacion. Kur shkoje tek subjekti ku duhet të dorëzojë kontejnerin, pronari i subjektit apo puntori hap plumcet e kontejnerit dhe pres të shkarkohet malli. Gjatë kësaj kohe unë qëndroj aty derisa të shkarkohet malli. I jap urdhërin e clirimit të doganës dhe i them të ma fotokopjoj dhe ja marr për ta dorëzuar tek parkingu i kamionëve në fund të 15 ditëshit. Gjatë shkarkimit të mallit nga kontejneri unë qëndroj tek kamioni ose në kabinë ose aty ku shkarkohet malli.

- Mbasi mabron shkarkimi mbyll dyert e kamionit dhe shkojë në parkingun e kamionëve.
- 2.2 Në datë 27.02.2018 unë kam shkuar në punë pasi kam pasur për të transportuar një kontenier tek Ambasada Amerikane. Kur kam shkuar tek destinacioni kam telefonuar numrin të cilin më ka dhënë Semi për të dorëzuar kontenierin. Unë kam qenë aty rreth orës 08:00 dhe ai më ka thënë se në atë orë nuk bëhej asnjë veprim dhe duhet të prisja. Rreth orës 08:30 kanë ardhur punonjësit e Ambasadës Amerikane dhe kanë kontrolluar kamionin me një pasqyrë nga jashtë dhe më pas kanë marrë mua dhe më kanë cuar te zyrat e tyre dhe më kanë kontrolluar. Në fund më kanë dhënë një letër ku më pas kam shkuar te kamioni dhe kam telefonuar personin që kisha për ti dorëzuar kontenierin dhe më ka thënë se për 10 minuta do të vinte bashkë me puntorët. Rreth orës 09:15 kam hyrë me kamion brenda Ambasadës dhe kam pritur të shkarkohej kontenieri. Pasi kam mbaruar shkarkimin kam shkuar për të dorëzuar kontenierin në Spitallë.
- 2.3 Më vonë më ka marrë në tel Semi dhe më ka pyetur se ku isha ku i kam thënë që isha në Vorë dhe po shkoja në Spitallë për të shkarkuar kontenierin. Ai më tha se kisha shkarkuar shumë shpejt dhe unë i kam thënë se ishin kompjutera dhe mbarova punë shpejt. Ok më tha ia dhe më tha do vish të marrësh një kontenier me banane për në Maminas, pasi kamionet e tjerë janë të zënë. Unë i kam thënë se po vij. Më tha- shko shkarko kontenierin në spitallë. Pasi kam shkakuar jam nisur për në port. Semi më ka dhënë letrat e kontenierit. Kam marrë letrat dhe kam shkuar tek trau dhe pasi jam regjistruar më kanë dhënë një letër të vogël ku shënohet numri kontenierit. Kam pozicionur kamionin tek kontenieri dhe ka ardhur vinci e ka ngarkuar. E kam ngarkuar dhe kam shkuar tek dogana ku kam dorëzuar letrat dhe më kanë thënë prit, gjatë kësaj kohe kam shkuar tek lokali dhe kam pirë kafe dhe më vonë kam shkuar të pyesë nëse kanë dalë letrat. Aty më kanë dhënë letrat dhe më kanë thënë që të shkoja tek skaneri. Kam shkuar me kamion tek skaneri dhe kam pritur deri sa më ka ardhur rradha. E kam nxjerr kamionin nga skaneri dhe po prisja për letrat. Kam shkuar tek sheshi i kontenierve dhe po prisja për letrat. Mbas gjysëm ore më kanë thënë që do i bëhej një kontroll i imtësishëm kontenierit dhe e kam cuar kamionin tek peshorja. Aty kam gjendur Donaldo Lushaj punonjës in e shoqërisë “Arbi Garden” me dy persona të tjerë nuk e di se kush ishin. Aty kanë ardhur edhe disa persona për të hapur kontenierin, e kanë filmuar me telefon dhe pasi e hapën, kanë marrë pirunin për ta shkarkuar arkat e bananeve. Pasi e kanë cpuar me trapano një nga personat që ishte brenda ka thënë “Bingo” se për cafrë nuk e di. Më pas ai persona tha që “Bera Shaka”. Njëri nga ata personat që e cpoi me trapano, e kishte lyer gishtin me atë cfarë kishte nxjerr trapano dhe shkoi tek një grua. Pasi u kthye përsëri më tha do rrini do prisni njëher. Unë po prisja aty

- bashkë me donaldon dhe dy personat që ishin me atë dhe persona të tjerë të doganës dhe policisë. Rreth orës 23:00 kanë dhënë urdhër që të ngarkoheshin bananet dhe në këtë kohë Donaldo ka telefonuar dikë tjetër për të ardhur për ta ndihmuar për të ngarkuar bananet. Pasi i kemi ngarkuar jo të gjitha pasi një pjesë nuk i merrte kontenieri, janë ngarkuar tek makinë Cady. Pasi morrëm letrat nuk na lejonin të dilnim nga Porti pasi nuk lejohej mbas orës 23:00. Donaldi ka marrë ne tel Agjentin Doganor dhe për punë 10 minuta ai ka arritur aty dhe ka folur me policët e traut dhe i kanë thënë se nuk mund të dilte. Ai ka marrë doganierin i cili ka ardhur aty dhe kanë debatuar me policët e traut. Pasi kanë folur në tel me shefat e vet kanë thënë që kamioni mund të dilte. Pasi kam shkuar tek magazina e shoqërisë Arbi Garden dhe po fillohej të shkarkohej ka ardhur policia dhe ka thënë “Mos lëviz”
- 2.4 Donaldon e kam takuar vetëm atë ditë. Herë të tjera kanë qenë puntorë të tjerë të firmës. Me Donaldon nuk jam takuar asnjëherë tjetër me atë dhe nuk kam folur asnjëherë në tel me Donaldon.
- 2.5 Arbër ÇEKAJ nuk e kam njohur më përpara dhe emrin e tij e kam dëgjuar për herë të parë kur më kanë pyetur në polici ditën e arrestimit.

### III. DEKLARIMI I DHËNË NGA ELIS TAHIRAJ

- 3.1 Unë kam 6 muaj që punojë në shoqërinë “Arbi Garden” dhe punojë shofer ku shpërndaj bananet. Ne mallim e marrim nga punonjësi Fatos LALA.
- 3.2 Mallin kur e shesim lekët ja dorëzojmë babait të Arbërit shtetasit Selim ÇEKAJ dhe rrogën e marrim te banka Pro Credit me kartë.

### IV. DEKLARIMI I DHËNË NGA MYSLIM DOMI

- 4.1 Në praktikën tonë të shkarkimit të konteniervë pronari e ka si praktikë pune që pas përfundimit të shkarkimit të kontenierit, ai del jashtë ambienteve të magazinës. Vetëm një rast ka pasur që unë me iniciativën time e kam mbajtur një kontenier në ambientet e magazinës sepse mbaroi vonë shkarkimi dhe skishte ku të shkonte kontinieri pasi nuk lejohej të shkonte në port. Të nesërmen pronari Arbri më ka marrë në telefon dhe më ka thënë se të kam porositur që të mos lejosh asnjë kontenier brenda ambienteve të magazinës dhe pse e kisha lënë mbrëm aty. Këtë fakt ai e kishte mësuar pasi kishte kontrolluar kamerat e magazinës. Ky ka qenë i vetmi herë që ka ndodhur.

### V. DEKLARIMI I DHËNË NGA ASLLAN DOMI



- 5.1 Unë kam rreth një vit e tre muaj që punojë në këtë punë dhe gjatë punës time unë mbaj kontakte me shtatsin Arbër ÇEKAJ. Për sa kohë që unë punoj në këtë firmë në cdo rast kontenierët pas shkarkimit të tyre largohen me mjetin që i sjell.

#### VI. DEKLARIMI I DHËNË NGA BESNIK DERVISHI

- 6.1 Unë kam rreth 5-6 muaj që punojë aty, kur na thërasin për punë për shkarkim. Unë sa herë kam shkuar aty kam komunikuar me një përgjegjës që quhet Tosi. Kur kemi punuar mua lekët gjithmonë mi ka dhënë Lymi dhe na paguanin 1200 leke për shkarkimin e kontenierit. Pasi ne shkarkojmë bananja futet nëpër dhomat frigoferike dhe kontenieri largohet për sa kohë kam unë që punojë në këtë firmë kontenieri nuk ka qëndruar asnjëherë. Ai largohet nuk e di se ku shkon ndoshta në port.

#### VII. DEKLARIMI I DHËNË NGA NUREDIN SEFERI

- 7.1 Po më datë 27.02.2018 rreth orës 12:15 më ka marrë në telefon përgjegjësi i firmës “Arbri Garden” i cili quhet Fatos. Unë kam rreth dy vjet që punojë në këtë firmë dhe jemi prezent në punë sa herë na kërkojnë për shkarkimin e kontenierve. Pas shkarkohet kontenieri, bananja futet nëpër dhomat dhe kontenieri largohet. Për sa kohë kam unë që punojë këtu kontenieri nuk ka qëndruar asnjëherë, nuk e di ku shkon ndoshta në port.

#### VIII. DEKLARIMI I DHËNË NGA SELMAN DASHI

- 8.1 Unë kam filluar punë pranë shoqërisë “Pelikani në datën 03.07.2017 deri në datë 21.06.2018. aty kam pasur detyrën e Dispecerit. Konkretisht unë kisha si detyrë menaxhimin e shoferëve të kamionëve, pra shpërndaja punën e kamionëve. Unë kisha listën e kamionëve dhe shoferat e punësuar tek kjo firmë. Pasi zyra qëndrore e kësaj kompanie më dërgonte me a-mail si filan kontenier është i lirë për tu transportuar për llogari të filan shoqërie, me marrjen e e-mail-it në varësi të kontenierit që do të transportohej caktoja kamionin e përshtashëm dhe shoferin që do kryente transportin.
- 8.2 Pasi vinin letrat nga agjenti doganor i firmës që kërkonte transportin e kontenierit, unë njoftoja shoferin për të marr kamionin dhe plotësoaj autorizimin e shoferit për të hyrë tek terminali dhe për të ngarkuar kontenierin. Kjo zakonisht është procedura që krueja unë për transportin e kontenierve. Kompania ka shumë shofera por ata që transportinin konteniera ishin 30 shofera.

- 8.3 Përzgjedhja e kamionit bëhej në varësi të llojit të kontenierit që do të transportohej pasi ka madhësi të ndryshme. Shoferët i përzgjidhja në varësi të rrugëve që kishin kryer, kush kishte më shumë apo më pak pasi edhe ata paguhen në bazë të rrugëve që kryejnë si dhe në varësi të asaj se cilin kisha të lirë dhe më afër.
- 8.4 Tani si datë nuk më kujtohet por për rastin konkret e mbaj mend dhe mund tju them se atë ditë kam marrë e-mail nga zyrat qendrore se ishin dy kontenier për tu transportuar për llogari të subjektit “Arbi Garden”, nga porti i Durrësit tek magazinat e subjektit në Maminas. Pasi kam marrë emailin, kam marrë në telefon shoferat Halit Celpica dhe e kam pyetur se ku ishte dhe ai më tha se ishte në park për të kryer një transport. I kam thënë se duhej të vinte tek porti pasi ishte për tu kryer një transport kontenieri. Më pas kam marrë në telefon Armando Pezakun dhe ai ishte i lirë. I pari futur Haliti dhe mbas tij Armando.
- 8.5 Për sa më pyesni unë deklaroj se ka qenë e rastësishme përzgjedhja e shoferëve, ishte koicidencë që kam telefonuar këta të dy.
- 8.6 Nuk e kam njohur administratorin e shoqërisë Arbri Garden vetëm kur ka dalë nëpër media kam mësuar kush ishte. As Donald Lushaj nuk e njoh dhe nuk kam asnjë marrëdhënie me këtë shetas.

#### IX. DEKLARIMI I DHËNË NGA EDMOND LOLA

- 9.1 Shoferi sipas rregullores tonë e ka për detyrë që të rrijë tek kamioni deri në momentin kur të shkarkohet malli dhe të largohet bashkë me kamionin dhe me kontenierin. Zakonisht kur ka ngarkesa që zgjasin në shkarkim shoferi mund të largohet të pijë ndonjë kafe ose të ushqehet dhe të kthehet kur të mbaroj shkarkimi.
- 9.2 Më pas shoferi merr kontenierin bosh dhe e transporton në terminalin e konteniervë nëse është frigoriferik dhe nëse është i thjeshtë e dërgon në parkun e firmës Pelikan.
- 9.3 Në lidhje me ngjarjen unë kam marrë dijeni nëpërmjet mediave ditën e nesërme. Kam marrë në telefon shoferin Armando PEAZKUN në mëngjes por ai smë është përgjigjur.
- 9.4 Në datë 28.02.2018 unë kam qenë në punë bashkë me kolegun tim Selman DASHI dhe jemi njoftuar me e-mail nga zyrat qendrore të Pelikan në lidhje me transportin e dy konteniervë të shoqërisë Arbri Garden. Mbaj mend që ka qenë rreth orës 15:00 kur jam njoftuar për këtë ngarkesë.

- 9.5 Kolegu im Selman DASHI ka marr në telefon një shofer që quhet Halit Qelpica dhe e ka lajmëruar që të afrohet për kryerjen e transportit frigoriferik për shoqërinë Arbri Garden. Më pas Selmani ka marrë në telefon disa shoferë të tjerë nëse është ndonjë i lirë dhe nuk ka gjetur asnjë të disponueshëm dhe mori shoferin Armando PEZAKU. Mesa mbaj mend Armando ishte me kamion në Tiranë por nuk e di se tek cili subjekt. Selmani i ka kërkuar që të afrohet në port për kryerjen e një transporti konteneri frigoriferik për llogari të shoqërisë Arbri Garden.
- 9.6 Unë Armando PEZAKUN e njoh vetëm si shofer i firmës Pelikan dhe nuk kam ndenjur ndonjë herë me këtë person për kafe dhe skam kaluar ndonjëher kohë me të. Me sa di unë ai ishte shofer i ri dhe punonte për firmën Pelikan prej rreth 6 muajsh. Nuk kam shumë informacion për këtë person pasi nuk e njoh mirë dhe kam komunikuar me të vetëm si shofer kur ai më nevojitej për ngarkesë.
- 9.7 Unë shtetasin Arbër ÇEKAJ nuk e njoh dhe nuk e kisha dëgjuar ndonjë herë si emër. Unë shtetasin Donald LUSHAJ e njoh pasi ka ardhur disa herë aty bashkë me Arlindin (Agjenti Doganor) duke u interesuar për kontenerët e tyre. Nuk kam ndonjë relatë me këtë shtetas dhe nuk kam kaluar asnjëherë kohë me të, përveçse momenteve kur ai është interesuar për transport.

#### X. DEKLARIMI I DHËNË NGA GENC MATAJ

- 10.1 Unë jam administrator i shoqërisë “Pelikani” dhe ditën që ka ndodhur ngjarja kam qenë në një varrim dhe rastësisht e kam marrëvesh për ngjarjen. Më pas kam shkuar në zyrë dhe jam interesuar se çfarë kishte ndodhur.
- 10.2 Në lidhje me shoferin Armando Pezakun atë e kam marrë në punë në datën 05.02.2017 dhe gjatë kësaj kohe nuk kam pasur ndonjë problem pasi ai është i njeri i papërtuar dhe punëtor.
- 10.3 Unë nuk e njoh pronarin e subjektit “Arbri Garden”, nuk kam asnjë marrëdhënie me të dhe nuk kam kontakte me të.
- 10.4 Konteneri sipas rregullores pasi shkarkohet kthehet gjithmonë në terminal. Ka patur një rast në Itali ku është kapur drogë në kamionin tonë, ku ne transportonim Gurë Dekorativ për një shoqëri dhe në këtë rast unë kam bërë kallëzim penal dhe shoferi nuk ka kmbajtur përgjegjësi pasi nuk ka pasur dijeni.

#### XI. DEKLARIMI I DHËNË NGA ERMIR MALIQATI

- 11.1 Unë punojë si Drejtorë i Përgjithshë, pranë firmës CMA-CGM albania shpk, e cila është një kompani që merret me transportin e konteniervë nga Porti i Durrësit në të gjithë botën dhe anasjelltas. Te kjo kompani unë kam pesë vite që punojë.
- 11.2 Unë mund të them që se subjekti Arbri Garden ka kërkuar një ofertë transporti për mallin banane me kontenitier frigoriferik. Pasi i kemi dhënë cmimet dhe kemi rënë dakort për ofertën tonë, përfaqësuesi i firmës Arbi Garden na ka dhënë të dhënat e firmës nisëse të mallit, detajet për konteniervët që kërkon për transport për cdo javë.
- 11.3 Këto të dhëna ne ja kemi dhënë zyrës tonë respektive në Kolumbi bashkë me Bokking Order (urdher transporti). Më pas përfaqësuesit e CMA CGM Kolumbi organizojnë transportin e këtyre konteniervë sipas kushteve të transportit të dërguara nga ne në Bokking Order (urdher transporti). Theksojë se kushtet tona të transportit si CMA CGM Albania me firmën Arbi Garden kanë qenë vetëm për transport detar nga anija Turbo në Kolumbi deri në Portin e Durrësit Shqipëri. Ndërsa për lëvizjet e konteniervit në territorin Kolumbian janë kryer nga përfaqësuesit e kompanisë CMA CGM Kolumbi.
- 11.4 Unë personalisht nuk kam pasur ndonjë lidhje shoqërore me Arbër Cekaj apo Donaldo Lushaj dhe jemi takuar vetëm për punë.

## XII. ANALIZA LIGJORE E FAKTEVE DHE VEPRAVE PENALE

- 12.1 Vlerësojmë se vendimi i marrë nga ana e Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk është marrë në përputhje me vlerësimin e drejtë të provave konform nenit 152 të K.Pr.Penale,<sup>1</sup> dhe në analizë të plotë ligjore të figurës së veprës penale. Nga provat e administruara në fazën e hetimit, për shkak të procedimit me formën e gjykimit të posaçëm, atë të gjykimit të shkurtuar, është provuar plotësisht fakti ligjor se nuk provohet autorësia e të gjykuarit Arbër ÇEKAJ në pjesëmarrjen e tij në një veprimtari të kundër ligjshme apo krijimin e një grupi të strukturuar kriminal penalisht, siç ka deklaruar gjykata ditën që ka shpallur vendimin.

<sup>1</sup> N.152 i K.Pr.Penale “Çmuarja e provave”

1. Çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi.

2. Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën.

- 12.2 Gjykata e Posaçme ka konkluduar se i gjykuari Arbër ÇEKAJ duhet të deklarohet fajtorë për veprat penale të parashikuar nga neni 283/a/1, 28/4, 333/a1 dhe 334 të Kodit Penal duke mos marrë në konsideratë të gjitha veprimet e kryera nga i gjykuari dhe në raport dhe dinamikë me veprimet e të gjykuarve të tjerë..
- 12.3 Gjykata e Posaçme, nuk ka pasur parasysh se, në respektim të drejtë të nenit 152 të KPP askush nuk mund të deklarohet fajtor me një provë të vetme qoftë edhe kur ajo është shkencore, pasi pranimi i së kundërtës, do t'i hapte rrugë një arbitrariteti, me pasojë shkeljen e të drejtave të individit në procesin penal dhe që pa prova, individë të akuzuar për vepra penale të deklarohen fajtorë dhe të vuajnë një dënim të padrejtë.
- 12.4 **Neni 380 i Kodit të Procedurës Penale, parashikon se, “për të marrë vendimin gjykata nuk mund të përdorë prova të tjera veç atyre që janë marrë ose janë verifikuar në shqyrtimin gjyqësor”;** po ashtu edhe nenin të 152 i KPP mbi çmuarjen e provave, dhe në konkluzion nga interpretimi i dy dispozitave të më sipërme vë rehet se, për rpara se të procedojë me zbatimin e nenit 152 të KPP, **gjykata duhet më parë të sqarojë provat mbi të cilat do të marrë vendimin.**
- 12.5 Në rastin konkret duke vlerësuar vendimmarrjen e gjykatës konstatojmë se, vlerësimi i provave nga ana e gjykatës nuk është bërë në përputhje me nenin 152/1 të KPP, në të cilin parashikohet se, *çmuarja e provave është përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë promovuese të tyre. Çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi.*
- 12.6 Problemi i të provuarit të akuzës është themelor për çdo poçes dhe kjo kërkon një analizë të plotë e të gjithanshme të provave që paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor duke mënjanuar mbivlerësimin e çdo prove, gjë që do të dëmtonte procesin gjyqësor. Nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale vetëm me një provë çfarëdo qoftë ajo edhe nëse është shkencore, nëse nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë. Nuk mund të ketë për gjykatën asnjë provë me vlera të paracaktuara e që t'a mbështesë vendimin e fajësisë apo pafajësisë vetëm me një provë pa u harmonizuar ajo me prova të tjera.
- 12.7 **Së pari, në përmbajtjen e nenit 238/a/2 të K. Penal sanksionohet se:**  
 Importi, eksporti, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si dhe farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Por kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjet në njëzet vjet. Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohet me burgim jo me pak se pesëmbëdhjetë vjet.

- 12.8 Legjislacioni jonë penal nëpërmjet kësaj vepre penale synon mbrojtjen e posaçme të marrëdhënieve juridike të vendosur për të siguruar kontrollin dhe rendin në veprimtaritë e importit, eksportit, tranzitimit dhe tregtimit ndërkombëtar të narkotikëve, kundër veprimeve e mosveprimeve kriminale.
- 12.9 Kjo vepër penale kryhet me dashje, me anë të veprimeve a mosveprimeve të kundërligjshme. Sipas rastit, ajo kryhet për motive apo edhe me qëllime nga më të ndryshmet, të fokusuara veçanërisht tek ato që lidhen me përfitimin material.
- 12.10 Konkluzioni i gjykatës dhe organit të akuzës mbi vërtetimin e elementëve ligjorë për konfigurimin e veprës penale për trafikimin e narkotikëve, parashikuar nga neni 283/a/1 të Kodit Penal nuk është i arsyetuar në mënyrë të hollësishme dhe në kontradiktoritet me palët në gjykim, arsyetimi i organit të akuzës nuk përshkruan në mënyrë analizuuese provat dhe faktet e mjaftueshme që mbështesin plotësimin e elementëve ligjorë të kërkuara për konfigurimin e kësaj vepre penale. Në të njëjtin konkluzion mund të arrihet edhe sa i takon vërtetimit dhe provuaries së elementit të bashkëpunimit të cilësuar të parashikuar nga neni 334 i Kodit Penal, element të cilin as prokurori nuk e ka hetuar në raport me provat dhe faktet por thjesht aludon, ngre alibi apo monton fakte të pavërteta.
- 12.11 Në lidhje me respektimin e anës objektive lidhur me llojin e bashkëpunimit, konkluzioni i organit të akuzës, sipas së cilës, marrëveshja e bashkëpunimit është materializuar pikërisht në veprimet konkrete që kanë ndërmarrë secili prej të pandehurve, nuk është i arsyetuar në mënyrë të hollësishme, përkundrazi në kundërshtim me provat konkrete që ekzistojnë.
- 12.12 Po ashtu, edhe ana subjektive e kësaj vepre, pra konkluzioni mbi përfytyrimin dhe ngjitjen e rolit të organizatorit për të pandehurin Arbër ÇEKAJ në marrëveshjen pjesëmarrëse dhe planin e të gjykuarve të tjerë, nuk është e arsyetuar në mënyrë të hollësishme, të bazuar mbi prova konkrete dhe të detajuara. Në këto kushte, pretendimet e ngritura nga gjykata dhe organi i akuzës, nuk kanë respektuar parimin e provuaries përtej çdo dyshimi të arsyeshëm lidhur me këtë akuzë.
- 12.13 Gjykata duhet ta mbështeste vendimmarrjen në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (indiciare) që duhet të provoheshin nga akuza, e cila nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Provat shkencore nuk kanë provuar lidhjen e provave materiale në mënyrë konkrete dhe direkte me të gjykuarin Arbër ÇEKAJ dhe nuk është arsyetuar se si ky konkluzion i organit të akuzës është arritur në mungesë të provave të tjera, si gjurmë gishtash që të vërtetonin kontaktin fizik të të gjykuarit me provat materiale, përgjimeve, dëshmime, mënyrën e futjes së lëndës narkotike në kontejner, mundësinë financiare për blerjen e lëndës narkotike apo provave të tjera shkencore.

- 12.14 Nga ana objektive veprimet e organizatorit qëndrojnë në bashkëpunimin e personave të tjerë për të kryer në të ardhmen veprën penale për zgjedhjen dhe rekrutimin e bashkëpunëtorëve, kërkimin dhe gjetjen e objektit të përshtatshëm ku do të kryhet vepra penale, përpunimin e mënyrës dhe gjetjen e mjeteve të nevojshme si dhe veprime të tjera të karakterit organizativ. Nga ana e organit të akuzës por edhe hetimit në asnjë moment nuk analizohet mënyra se si e ka ngarkuar i pandehuri Arbër ÇEKAJ lëndën narkotike, kryerjen e një analize ekonomike nëse ky i pandehur duke qenë se sipas organit të akuzës kishte rolin e organizatorit a kishte mundësin për blerjen e një sasisë prej 613 kilogram Kokaine !!! A kishte udhëtuar i pandehuri në harkun kohor nga momenti i porositjes së mallit banane në shtetin Kolumbian !!! A kishte mundësi ligjore që ky i pandehur të dinte numrin e kontejnerëve që do të ngarkoheshin me banane nga shoqëria Banacol në Kolumbi !!! Përse nuk e përmend organi i akuzës faktin që kontejnerët nuk dalin nga porti Turbo pa kontrollin dhe Certifikimin nga ana e Policisë së Anti Narkotikut Kolumbian !!!
- 12.15 Përgjigja e këtyre pyetjeve por edhe nëse hetimi do të ishte shtrirë dhe realizuar mbi këto këndvështrime atëherë këto fakte dhe prova mund të implikonin të pandehurin Arbër ÇEKAJ, atëherë mund të kishim konfigurimin nga ana objektive të rolit të organizatorit në kryerjen e veprave penale.
- 12.16 Por nga provat rezultojnë të provuara faktet që i pandehuri Arbër ÇEKAJ gjatë periudhës që është ngarkuar malli banane por edhe më përpara nuk ka qenë në Kolumbi, rezulton i provuar fakti që Arbër ÇEKAJ nuk ka dhe nuk ka pasur mundësi financiare për të blerë sasinë prej 600 kilogram kokainë i cila ka një vlerë mesatare rreth 50 milion Euro, rezulton i provuar fakti që Arbër ÇEKAJ nuk e ka ditur se cilët do të ishin kontejnerët që ishin caktuar për të ngarkuar mallin e tij banane pasi kjo varej vetëm nga shoqëria CMA CMG Kolumbi apo shoqëria Banacol (shoqëri këto që nuk ishin përzgjedhur nga Arbër ÇEKAJ) fakt ky i vërtetuar edhe nga dëshmia e administratorit të shoqërisë CMA CMG Albania Ermir MALIQATI, faktin që kontejnerët janë kontrolluar nga Policia e Anti Narkotikut Kolumbian.
- 12.17 Ky fakt vërtetohet edhe nga aktet shkresore Bill of Landing e cila është i vetmi dokument i cili përmban edhe të dhënat e kontejnerit për numrin e tij i cili i është dërguar shoqërisë Arbri Garden vetëm një javë më vonë pasi ngarkesa ishte ngarkuar nga porti Turbo në Kolumbi.
- 12.18 Rezulton e provuar edhe nga vetë e-maili që ka dërguar përfaqësuesi më i lartë i shoqërisë CMA CMG me seli në Marsejë ku ka shpjeguar detajet e kontejnerit frigoriferik me numër GESU9449548 “Kontejnerët frigoriferik shkarkohen në Kolumbi, zakonisht bosh dhe lëshohen tek CFS (Compania Fruitera de Sevilla LLC), një nën kontraktues i shoqërisë Banacol, i ngarkuar për marrjen në posedim të kontejnerëve të zbrazët dhe duke i përgatitur ato për mbushjen e bananeve. Kontejneri GESU9449548 u shkarkua nga HSL Nike më datë

02.01.2018 dhe u dorëzua në CFS në orën 22:30 dhe që nga ai moment kontejneri ishte nën kujdestarinë e vetme dhe përgjegjësinë e CFS/Banacol. CFS inspektoi kontejnerin më datë 04.01.2018 dhe riparimet e vogla u kryen në kontejner më datë 09.01.2018 (duke zëvendësuar 11 vidat e humbura në aparatin avullues). Këto riparime u faturuan 58,29 dollarë të cilat janë paguar nga shoqëria CMA CMG. Më datë 04.01.2018 CMA CMG Kolumbi mori një rezervim për ngarkimin e dy kontejnerëve nga Turvbo në Durrës për kompaninë eksportuese Baccota SAS. Rezervimet u pranuan nga CMA CGM Kolumbi dhe dy kontejnerët u mbushën nga shoqëria Banacol dhe nën përgjegjësinë e shoqërisë CMA CMG”

- 12.19 Nga ana subjektive veprimtaria e organizatorit karakterizohet nga fakti se ai e di që po organizon dhe drejton bashkëpunëtorë të tjerë për kryerjen e veprës penale, parashikon ardhjen e pasojave të dëmshme nga veprimet e përbashkëta të bashkëpunëtorëve që janë nën drejtimin e tij dhe dëshiron ardhjen e pasojave kriminale. Roli i organizatorit në bashkëpunim për kryerjen e veprës penale mund të jetë dhe drejtues i bashkëpunëtorëve gjatë kryerjes së veprës penale (ndarja e roleve, instruktimi i bashkëpunëtorëve se si duhet të veprojnë, drejtimi efektiv në vendin e kryerjes së veprës penale) etj. Nga provat por edhe nga hetimi rezulton se i pandehuri Arbër ÇEKAJ nuk mund të ketë qenë në dijeni të numrit të kontejnerëve, nga provat nuk rezulton që ai të ketë komunikuar me ndonjë person për blerjen e lëndës kokainë, nga provat nuk rezulton që ai të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë CMA CMG Kolumbi apo shoqërinë Banacol, nuk rezulton e provuar që i pandehuri Arbër ÇEKAJ të ketë paguar për riparimin e kontejnerit atje, fakt ky që fshihet nga organi i akuzës por edhe shoqëria CMA CMG pasi këto janë shërbime që paguhen nga ata si pronarë të kontejnerit.
- 12.20 Në e-mailin e dërguar nga përfaqësuesi i shoqërisë CMA CMG Marsejë Mathias BESNARD fshihet fakti që kontejnerët u vulosën në emër të dërguesit. Por nga provat dhe fakti që është cilësuar edhe vetë nga organi i akuzës ka rezultuar se në brendësi të kontejnerit janë gjetur vula e shoqërisë CMA CMG. Pra kontejneri është i vulosur me plumbçet e sigurisë të shoqërisë CMA CMG dhe shoqërisë Banacol.
- 12.21 Pra përfshirja e pandehurit Arbër ÇEKAJ në veprimtarinë kriminale apo kryerja e veprave penale nga ana e tij me cilësinë e organizatorit të grupit të strukturuar kriminal nuk vërtetohet me prova konkrete, të cilat shpjegojnë në mënyrë kategorike të gjithë veprimet aktive në kryerjen e veprave penale si nga ana objektive por edhe nga an subjektive që kërkohet nga ligji për veprimtarinë e organizatorit.
- 12.22 Konkluzioni i organit të akuzës, sipas të cilit, të gjithë personat e përfshirë në grupin e strukturuar kanë trafikuar lënë narkotike, në formën e eksportit, nuk ka respektuar përcaktimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale. Në zbatimin e nenit 152/2 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata e themelit duhet të vlerësojë çdo element indiciar



- provues, duke shqyrtuar aftësinë e tyre provuese në drejtim të tregimit të përgjegjësive së të pandehurit, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar kriterin dhe logjikën e ndjekur nëpërmjet një arsytimi korrekt juridik.
- 12.23 Megjithatë, ligji procedural lejon edhe vlerësimin e indicieve rreth ekzistencës një fakti, por me kusht që “indiciet” të jenë të shumta, të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, sipas nenit 152/2 të Kodit të Procedurës Penale. Më poshtë po argumentojmë dhe po kundërshtojmë në mënyrë kategorike të gjitha indiciet që ka ngritur organi i akuzës në provimin e fajësisë për të pandehurin Arbër ÇEKAJ.
- 12.24 Gjithashtu organi i akuzës me qëllim nuk ka mbledhur dhe nuk ka shqyrtuar provat që shfajësojnë apo janë në favor të të pandehurit Arbër ÇEKAJ në kundërshtim me nenin 8/a të Kodit të Procedurës Penale.
- 12.25 Gjykata dhe organi i akuzës argumentojnë se implikimi i Arbër ÇEKAJ në veprimtarinë kriminale dhe bashkëpunimin me anëtarët e tjerë të grupit provohet nga “fakti se më datë 28.02.2018 është bërë këqyrja e të dhënave të sistemit TIMS për shtetasin Arbër ÇEKAJ dhe ka rezultuar se dalja e fundit e regjistruar është më datë 12.03.2015 nëpërmjet pikës së Kalimit Kufitar Rinas dhe hyrja e fundit më datë 11.02.2018 ora 21:55 nëpërmjet pikës Kufitare Murriqan.” Nga provat rezultojnë Proces Verbal për Këqyrjen dhe Marrjen e Provës Materiale datë 28.02.2018, e marrë nga oficeri i policisë gjyqësore në Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, Migena Haxhi. Më datë 28.02.2018 është bërë këqyrja e të dhënave të sistemit TIMS për shtetasin Arbër ÇEKAJ dhe ka rezultuar se dalja e fundit e regjistruar është datë 12.03.2015 nëpërmjet pikës së Kalimit Kufitar Rinas dhe hyrja e fundit më datë 11.02.2018 ora 21:55 nëpërmjet pikës Kufitare Murriqan. Ky fakt është paraqitur në mënyrë të qëllimshme për të fajësuar dhe rënduar pozitën e të pandehurit Arbër ÇEKAJ, ndërkohë që nga prova e depozituar nga prokurori rezultojnë se dalja e fundit e shtetasit Arbër ÇEKAJ rezultojnë sipas sistemit TIMS që është data 07.02.2018 ora 02:20, por nga sistemi TIMS rezultojnë se nga viti 2015 ky shtetas ka rreth pesëdhjetë (50) dalje jashtë Republikës së Shqipërisë dhe jo një siç ka pretenduar oficeri i policisë gjyqësore dhe prokurori në konkluzionet përfundimtare ku ka kërkuar dhe dënimin e shtetasit Arbër ÇEKAJ me 21 vite burgim, bazuar mbi këtë provë.
- 12.26 Gjykata dhe organi i akuzës argumentojnë se implikimi i Arbër ÇEKAJ në veprimtarinë kriminale dhe bashkëpunimin me anëtarët e tjerë të grupit provohet nga “fakti i komunikimit i datës 01.04.2015 deri më datë 10.04.2015 (nga informacionet rezultojnë se në këtë periudhë në Ekuador është kapur një sasi lënde narkotike kokainë, për të cilën dhe është dyshuar Arbër ÇEKAJ. Konkretisht kjo bisedë zhvillohet ndërmjet komunikuesve Arbër ÇEKAJ dhe “Anoïrde” dhe është e datës 05.04.2015” Në lidhje me pretendimin e ngritur nga ana e organit të akuzës se nga informacionet rezultojnë se në këtë periudhë në Ekuador është kapur një sasi lënde narkotike kokainë për të cilën dhe është dyshuar Arbër ÇEKAJ, prapësojmë se argumenti dhe analiza ligjore e përdoruar nga ana e

- organit të akuzës nuk është e mbështetur në një provë konkrete, Vendim Gjyqësor të Autoriteteve Ekuadoriane apo një vendim të Prokurorisë në Shtetin Ekuadorian ku i pandehuri Arbër ÇEKAJ të ketë pasur cilësinë e personit të hetuar, masë sigurimi, apo personit me cilësinë e të pandehurit dhe fatin e mbarimit të kësaj çështje ku ai të jetë shpallur fajtor apo i pa fajshëm. Në zbatim të parimit të “*presumimit të pafajësisë*” parashikuar edhe në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale por edhe në KEDNJ. Përcaktimi i vërtetësisë së provës që është vënë si kusht nga ligjvënësi për të pasur një proces ligjor çmuarje të saj, nënkupton verifikimin se ku konsiston lidhja e rrethanës apo objektit material konkret me objektin e të provuarit në çështjen konkrete. Pretendimi i organit të akuzës mbi përfshirjen e Arbër ÇEKAJ në një rast përpara pesë viteve në shtetin Ekuadorian nuk qëndron i mbështetur në një provë konkrete në respektim të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale por thjesht paraqitet si pretendim dhe mendim subjektiv të prokurorit. Ligji procedural penal në asnjë nen të tij apo paragraf nuk përcakton se mendimi subjektiv i prokurorit është mjet provues për përcaktimin e fajësisë apo pafajësisë për të pandehurin.
- 12.27 Në lidhje me bisedën që organi i akuzës e sjell me cilësinë e indicies midis Arbër ÇEKAJ dhe personit Anodire theksojmë dhe prapësojmë që kjo bisedë sipas transkriptimit është zhvilluar përpara pesë viteve dhe nuk ka asnjë lidhje me akuzën që është objekt gjykimi pra nuk tregon asnjë lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për implikimin e të pandehurit si në atë periudhë por edhe sot për faktin penal që i atribuohet. Edhe nëse e analizojmë përmbajtjen e bisedës në asnjë moment nuk del ndonjë fakt apo e dhënë që midis palëve të jetë diskutuar për lëndë narkotike apo veprime të kundërligjshme. Fakti që i pandehuri ka thënë “*më ka ndodhur diçka e keqe, më kanë bërë diçka të keqe*” nuk nënkupton përfshirjen në ndonjë veprimtari të paligjshme.
- 12.28 Nëse organi i akuzës mendonte ta përdorte këtë transkriptim bisede në lidhje me përforsimin e faktit që i pandehuri në atë periudhë ka qenë i përfshirë në ndonjë aktivitet të jashtëligjshëm në shtetin Ekuadorian (sipas argumentit që përcjell organi i akuzës) duhet të kishte marrë me cilësinë e provës nga ky shtet për këtë periudhë një informacion apo prova konkrete, Vendime Gjykate apo çdo lloji prove tjetër, të cilat në kuptim të ligjit procedural penal kanë fuqinë provuese të faktit të pretenduar. Në kushtet kur kjo provë nuk ekziston në mënyrë kategorike kjo lidhje dhe alibi që paraqet organi akuzës nuk qëndron në cilësinë e provës dhe nuk jep të dhëna as për elementin dyshues të krijuar.
- 12.29 Gjykata dhe organi i akuzës argumentojnë se “nga komunikimi i përdoruesit Arbër ÇEKAJ me Donaldo LUSHAJ më datë 10.11.2014, ku flitet për problem të internetit të zyrës, kërkesë e bërë nga Arbëri për të bërë këmbimin e 20 apo 30 mijë dollarëve”. Edhe në këtë moment prokurori nuk i tregon gjykatës se cila është kjo bisedë e transkriptuar, çfarë date mban,

- çfarë nr. transkriptimi dhe pse nuk e paraqet të gjithë bisedën !!! Transkriptimi i bisedës i paraqitet gjykatës për ta vlerësuar me cilësinë e provës e plotë dhe në kontekst siç është e zhvilluar dhe jo duke shkëputur pjesë nga biseda me qëllimin për ta paraqitur si alibi. Kjo bisedë e shkëputur e cila sipas organit të akuzës provon përfshirjen e të pandehurit Arbër ÇEKAJ sëbashku me të pandehurin Donaldo LUSHAJ është e qëllimshme prandaj organi i akuzës nuk paraqet asnjë identifikim të transkriptimit të kësaj bisede, çfarë date ? çfarë ore? Çfarë nr. transkriptimi mban ??.
- 12.30 Nëse i referohemi transkriptimit të kësaj bisede rezulton se i pandehuri Arbër ÇEKAJ i ka thënë Donaldo LUSHAJ për këmbimin e valutës për ta bërë Bledi, i cili është punonjës i Bankës Pro Credit në Tiranë. Meqenëse për organin e akuzës kjo ishte një e dhënë shumë e rëndësishme dhe në respektim edhe të nenit 8/a të Kodit të Procedurës penale përse nuk hetoi se cili ishte personi me emrin Bledi. Përse nuk e ka pyetur asnjëherë Donaldon LUSHAJ apo Arbër ÇEKAJ në lidhje me këtë person dhe nëse ky person nga pozicioni i punës që ka zhvilluar atë periudhë a kishte mundësi për kryerjen e ndërrimit të valutës ???
- 12.31 Ligjvënësi me ndryshimet e reja të reflektuara me ligjin 35/2017 në Kodin e Procedurës Penale dhe pikërisht nenin 8/a, duke u mbështetur edhe në raport me frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë por edhe akteve ligjore ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ka pasur si qëllim primar dhe fundor mos lejimin e organit të akuzës të dëmtojë të pandehurin në hetimin e çështjes duke e detyruar që të shqyrtojë provat që e shfaqësojnë të pandehurin. Pra organi i akuzës në rastin konkret kishte të dhënë që Arbri i ka thënë Donaldos për kryerjen e një valute dhe i ka thënë të flasë me Bledin që ka punuar në Bankën Pro Credit, bankë e cila shoqëria Arbëri Garden ka bashkëpunuar për kryerjen e shumë veprime të cilat lidheshin me aktivitetin tregtarë por edhe ka qenë kredimarrës pranë kësaj banke.
- 12.32 Gjykata dhe organi i akuzës citojnë jo saktë deklarin e përfaqësuesit të shoqërisë CMA CMG Albania, Ermir MALIQATI ku citon se “shtetasi Ermir Maliqati ka shpjeguar mënyrën si kryhet transporti i një ngarkese me kontejner nga vende të ndryshme në drejtim të Shqipërisë dhe anasjelltas. Ai shpjegon se kontaktet me porositësin bëhen nëpërmjet e-mailit ose paraqitjes së tij personalisht pranë zyrave të CMA CMG. Japin të dhëna për ngarkesën që duan të transportojnë, vendin e nisjes dhe vendin e destinacionit. Mbasi biem dakord për çmimin atëherë përpilohet një kontratë Bill of Landing, ku jepen të dhëna në lidhje me firmën që do të dërgojë mallin, llojin e mallit, peshën, llojin e kontejnerit, **numrin e kontejnerit**, firmën që do e presi mallin në vendin e destinacionit.” Nuk ka pasur të dhëna në lidhje me mënyrën si do të ngarkohet ky kontejner me mallin që do të transportohet”. Rezulton e provuar nga vetë dëshmia e dhënë nga Ermir MALIQATI se ai sqaron në mënyrë të detajuar dhe kronologjike mënyrën e ngarkimit të mallit banane dhe citon konkretisht se “ dua të them se mënyra e operimit për kryerjen e një

transporti mallrash me kontejner bëhet fillimisht, një klientë bën një kërkesë me e-mail ose verbalisht pranë zyrave tona. Klienti na përshkruan portin dhe vendin ku do të merret malli, tipin e kontejnerit që kërkon dhe llojin e mallit që do të transportohet. Më pas nga ana jonë kontaktohen zyrat qendrore të CMA CMG në Marsejë, Francë nga të cilat merret edhe kostoja e transportit dhe njoftohet klienti me ofertën tonë. Bim dakord edhe për kushtin e lëvrimin të mallit i cili ka të bëjë me vendodhjen e mallit dhe mënyrën e transportit. Nëse dokortësobemi të dyja palët me kushtet atëherë fillon procedura e transportit. **Caktimi i kontejnerit për kryerjen e një transporti zgjidhet nga ana jonë dhe bëhet në mënyrë rastësore. Thjesht përzgjidhet lloji i kontejnerit të përshtatshëm për llojin e mallit.** Konkretisht nëse do të kryhet një transport nga Shqipëria në dalje dhe klienti kërkon që malli të merret nga magazina ku është e magazinuar me transportin tonë të CMA CMG Albania, **atëherë ne si firmë njoftojmë kompaninë Pelikani që të kryejë një transport nga pika ku ndodhet malli deri në destinacion. Firma Pelikan cakton një shofer bashkë me kamion në mënyrë rastësore ose sipas rendit dhe gjendjes që kanë në park. Kjo ishte procedurë për nisjen e një ngarkese nga Shqipëria në drejtim të një vendi tjetër, por ju shpjegoj se e njëjta procedurë është edhe anasjelltas**”

- 12.33 **Nga analiza dhe përmbajtja e dëshmisë së Ermir MALIQATIT në raport me dëshminë që ka pasqyruar organi i akuzës në konkluzionet e tij rezulton së pari, se organi i akuzës qëllimisht ka shtuar sikur Ermir Maliqati ka deklaruar se pala porositëse ka dijeni për numrin e kontejnerit, fakt i cili nuk është deklaruar përkundrazi në asnjë paragraf të deklarimit por përkundrazi citohet se kontejneri përzgjidhet nga shoqëria CMA CMG Albania, së dyti, Ermir MALIQATI ka shpjeguar procedurën dhe mënyrën se si ndiqet për nisjen e ngarkese nga Shqipëria në drejtim të një vendi tjetër dhe jo siç duhej të kishte hetuar organi i akuzës procedurën e ngarkesës nga Kolumbia në Shqipëri fakt i cili pavarësisht nga ana e organit të akuzës është mjaftuar hetimi i këtij momenti vetëm duke marrë një e-mail sqarues nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë CMA CMG Marsejë, Francë që në analizë të ligjit procedural penal nuk ka fuqinë provuese dhe të një prove, pavarësisht se pretendohet se ai është përfaqësues ligjor, nga aktet e fashikullit gjyqësor nuk disponohet asnjë provë shkresore që tregon se cili është ky person, çfarë lidhje ka me shoqërinë CMA CMG.**
- 12.34 **Ky e-mail sqaron shumë qartë faktin nëpërmjet procedurës së ndjekur që i pandehuri Arbër ÇEKAJ nuk ka pasur asnjë detyrim ligjor në lidhje me ngarkimin e asaj ngarkese në Kolumbi pasi përgjegjëse është shoqëria nisëse e mallit. Pra veprimi i vetëm që ka kryer i pandehuri Arbër ÇEKAJ është porositja e mallit banane dhe mënyra dhe procedura se si është ngarkuar malli në portin Kolumbian është përgjegjësi vetëm e shoqërive CMA CMG Kolumbi, SFC dhe Banacol shoqëri të cilat nuk kanë bashkëpunuar asnjëherë me shoqërinë Arbri Garden.**
- 12.35 Nëse do ti referohemi provave shkresore të dala nga Drejtoria e Përgjithshme e

- Doganave rezulton e provuar se shoqëria Arbri Garden prej vitit 2013 deri në vitin 2018 ka bashkëpunuar për porositjen e bananeve, vetëm me dy shoqëri, të cilat janë shoqëria C.I CONDEX S dhe shoqëria C.IBACCOTA.
- 12.36 Edhe sikur të marrim të mirëqenë faktin se lënda narkotike e llojit kokainë do të gjendej e fshehur në brendësi në bananeve sërisht i pandehuri Arbër ÇEKAJ nuk mund të mbante përgjegjësi ligjore pasi ai as nuk ka qenë prezent në momentin e furnizimit dhe banania nuk është pronësi e tij por e shoqërisë Baccota. Veprimi i vetëm që ka kryer Arbër ÇEKAJ në të gjithë këtë veprimtari ka qenë porositja e bananeve dhe asnjë veprim tjetër ku organi akuzës mundohet me të gjitha format për t'ia faturuar Arbër ÇEKAJ, por jo duke hetuar dhe duke u bazuar në prova të përcaktuara sipas ligjit procedural penal por thjesht duke aluduar dhe ngritur dyshime subjektive, *së treti, Ermir MALIQATI ka sqaruar se ka pasur të dhëna pasi e sqaron se ndiqet e njëjta procedurë për ngarkesat edhe nga shtetet e tjera në drejtim të Shqipërisë dhe jo siç e përshkruan dhe e pretendon organi i akuzës se nuk ka pasur të dhëna për mënyrën si do ngarkohej kontejneri.*
- 12.37 Gjykata dhe organi i akuzës pretendojnë se *“nga praktika e lëvizjes së kontejnerëve, nga deklaratimet e personave që tregojnë rrethana hetimi, kontejneri do të transportohej në terminalin e Portit të Durrësit menjëherë pas shkarkimit të ngarkesës me banane. Për pasojë provat e administruara tregojnë se pikërisht ky ambient, magazina i firmës Arbri Garden ka qenë vendmbërritja e parë e lëndës narkotike.”* Në lidhje me këtë argument të organit të akuzës i cili sërisht manipulon faktet konkrete dhe mundohet ti kthejë në anën e kundërt, citojmë se nga deklaratimet e shtetasit Armando PEZAKU citohet se “Mbasi mbaron shkarkimi i kontejnerit unë e çojë në parkingun në Spitallë. Edhe kontejnerët frigoriferik i kam çuar në Spitallë tek parkingun.” Deklarimin e Edmond LOLËS “Shoferi kontejnerin bosh e dërgon në parkun e firmës Pelikan” por edhe deklarimi i personave të tjerë të cilët kanë konfirmuar faktin që kontejneri ikte nga mbas shkarkimit dhe shkante ose në parkun e shoqërisë Pelikani ose në Port në terminalin e kontejnerëve.
- 12.38 Paragjykimin e kësaj çështje organi i akuzës e ka mbajtur që në seancën e parë për caktimin e masës së sigurimit personal ndaj të pandehurit tjetër Donaldo LUSHAJ, ku ka replikuar më përfaqësuesin mbrojtës se përse është arrestuar Donaldo LUSHAJ kur nga provat (pamjet filmike) rezulton se ai ka qenë në zyrën e tij në momentin e shkarkimit të bananeve. Prokurori ka marrë cilësinë e një parashikuesi të veprimeve në të ardhmen, duke e paragjykuar njëkohësisht edhe pafajësinë e Donaldo LUSHAJ duke u shprehur se “Donaldo LUSHAJ DO TA HAPTE KONTEJNERIN” (ju lutemi referohuni procesverbalit të seancës për verifikimin e kushteve të masës së sigurimit personal ndaj Donaldo LUSHAJ dhe Armando PEZAKU).
- 12.39 Është fakt që organi i akuzës ka qenë në dijeni që në momentin kur e ka konstatuar lëndën narkotike brenda kontejnerit që nuk ishte pronë e shoqërisë Arbri Garden dhe organi i akuzës duhej të kishte pritur se ku do të shkante ky kontejner. Do të hapej

- brenda magazinës së shoqërisë Arbri Garden apo do të shkonte pranë destinacionit të CMA CMG për tu hapur apo në çdo lloji destinacioni tjetër dhe kush do të kishin qenë personat e interesuar për marrjen e sasisë së lëndës narkotike brenda kontejnerit të shoqërisë CMA CMG. Këtë veprim hetimor organi akuzës veprroi ta faktonte me anë të një hetimi special duke realizuar Dorëzimin e Kontrolluar, duke e mbikëqyrur me anë të forcave të policisë dhe forcave operationale ndjekjen e kontejnerit **dhe ka vendosur të ndërhyjë pikërisht në momentin që bananet nuk ishin shkarkuar nga kontejneri dhe në momentin që ai ishte në magazinën e shoqërisë Arbëri Garden, me qëllimin e vetëm për t'ia faturuar kësaj shoqërie dhe duke krijuar dhe futur në grup shoferin dhe punonjësën e shoqërisë.**
- 12.40 Gjykata dhe organi i akuzës pretendojnë se “bindje e plotë për implikimin e të pandehurit Arbër ÇEKAJ në kryerjen e kësaj veprë penale, krijohet edhe nga disa momente të rezultuara nga pyetja e tij në cilësinë e personit nën hetim, ku ai fillimisht sëbashku me mbrojtësin e tij interesohet për kushtet dhe përfitimet e mundshme nga një marrëveshje bashkëpunimi me organin e prokurorisë dhe më pas deklaroi se nuk ka gjë për të deklaruar, çka të lë të kuptosh se mund të jetë i gatshëm të jap shpjegime për implikimin e tij” . Ky pretendim i ngritur nga organi i akuzës nuk mbështet në një provë konkrete por interpretohet në mënyrë subjektive, pasi rezultoi që i pandehuri ARBËR ÇEKAJ ka refuzuar të mos japi asnjë deklaratë. Ndërsa prokurori Kondili e ka pyetur nëse nuk do të jepte deklaratë tani apo asnjëherë ? Arbër ÇEKAJ i është përgjigjur se në Shqipëri përfaqësohet nga av. Maksim HAXHIA. Avokati Gjerman sipas procedurës në shtetin Gjerman e ka pyetur prokurorin se me çfarë kushtesh vinte në Gjermani dhe nëse ja hiqnin masën e sigurimit personal ndaj të pandehurit ai ishte i gatshëm të kthehej dhe të përballej me akuzën, por në liri dhe jo në kushtet e një arrestimi.
- 12.41 Gjykata dhe organi i akuzës pretendojnë se “provë e plotë në ngarkim të atij është edhe largimi drejt Gjermanisë më datë 25.02.2018, pra dy ditë përpara lirim të kontejnerëve” . Faktin e largimit të të pandehurit Arbër ÇEKAJ në drejtim të Gjermanisë organi e akuzës e lidh me faktin e pasjes dijëni për lëndën narkotike.
- 12.42 Së pari, ky argument dhe alibi e organit të akuzës bie poshtë me provën dhe faktin që i pandehuri Arbër ÇEKAJ ka qenë në dijeni të kontrollit të kontejnerëve të tij nga ana e Policisë së Anti Narkotikut në Livorno të Italisë, fakt që shpjegohet edhe nga komunikimi midis atij dhe Ermir MALIQATIT por edhe nga vetë deklarimi i këtij të fundit për shkak të tarifës së lartë që i kishin vendosur për të paguar. **Pra nëse ai do të kishte qenë në dijeni të drogës në kontejner ai do të ishte larguar nga Shqipëria që në muajin Shkurt të vitit 2018 kur u kontrollua kontejneri në Livorno të Italisë.**
- 12.43 Së dyti, argumenti i organit të akuzës bie poshtë edhe për faktin që i pandehuri ka qenë i njohur me detyrimin ligjor për skanimin e kontejnerëve jo vetëm në Republikën e Shqipërisë detyrim që rrjedh nga ligji 123/2013 “PËR FINANCIMIN,NGRITJEN DHE OPERIMIN E SHËRBIMIT TË SKANIMIT TË KONTEJNERËVE E

AUTOMJETEVE TË TJERA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE TARIFËS SË SHËRBIMIT TË SKANIMIT”

12.44 Së treti, argumenti i organit të akuzës bie poshtë edhe për faktin se largimi dy ditë apo pesë ditë përpara se të vinin kontejnerët e shoqërisë Arbëri Garden për zhdoganim rezultojnë e provuar nga kryqëzimi i provave, të dhënat e të gjitha Import/Eksport e kryera nga shoqëria Arbëri Garden nga periudha Janar 2013 deri në 05 Tetor 2019 dhe datat e Daljeve sipas Procesverbalit për Këqyrjen dhe Marrjen e Provave Materiale nga sistemi TIMS.

1. Rezultojnë se në datën 22.01.2018 është zhdoganuar malli me Nr. Deklarate Doganore 7624 dhe Arbër Çekaj ka dalë jashtë Shqipërisë më datë 17.01.2018 nga Rinasi (5 ditë përpara).
2. Rezultojnë se në datën 29.01.2018 është zhdoganuar malli me Nr. Deklarate Doganore 10772 dhe Arbër Çekaj ka dalë jashtë Shqipërisë më datë 27.01.2018 nga Muriqani (2 ditë përpara).
3. Rezultojnë se në datën 06.11.2017 dhe 06.11.2017 është zhdoganuar malli me Nr. Deklarate Doganore 131954 dhe 131965 dhe Arbër Çekaj ka dalë jashtë Shqipërisë më datë 05.11.2017 nga Qaf morina (1 ditë përpara).
4. Rezultojnë se në datën 24.10.2017 është zhdoganuar malli me Nr. Deklarate Doganore 125865 dhe Arbër Çekaj ka dalë jashtë Shqipërisë më datë 21.10.2017 nga Qaf morina (3 ditë përpara).
5. Rezultojnë se në datën 27.09.2017 është zhdoganuar malli me Nr. Deklarate Doganore 113266 dhe Arbër Çekaj ka dalë jashtë Shqipërisë më datë 30.09.2017 nga Morina (3 ditë përpara).
6. Rezultojnë se në datën 27.09.2017 është zhdoganuar malli me Nr. Deklarate Doganore 113266 dhe Arbër Çekaj ka dalë jashtë Shqipërisë më datë 29.09.2017 nga Morina (2 ditë përpara).
7. Rezultojnë se në datën 22.08.2017 është zhdoganuar malli me Nr. Deklarate Doganore 97392 dhe Arbër Çekaj ka dalë jashtë Shqipërisë më datë 26.08.2017 nga Qaf morina (3 ditë përpara).

12.45 Pra pretendimi i ngritur nga ana e organit të akuzës në lidhje me faktin e largimit të Arbër ÇEKAJ dy ditë përpara për shkak të dijenisë bie në mënyrë kategorike nga provat e pakontestueshme që paraqitëm më lartë por edhe për faktin që kjo është një rutinë e përhershme në veprimtarinë tregtare që ai realizon.

12.46 Së katërti, fakti i largimit të Arbër ÇEKAJ për në Gjermani ka qenë për arsye familjare dhe kjo konfirmohet edhe nga transkriptimi i bisedave midis atij dhe

- punonjësit të kompanisë Alb Tours dhe Fly Kosova ku interesohet për prerjen e biletave. Fakti që ka ikur nga Kosova ka konsistuar në gjetjen e biletës më të lirë nga Prishtina prandaj edhe rezultojnë që ai ka udhëtuar shumë herë nga Kosova. Nga komunikimet del që ai po interesohet për blerjen e disa mobilieve në Gjermani dhe do të kthehet me makinë nga Gjermania në Shqipëri.
- 12.47 Rezultojnë se organi i akuzës në referim të nenit 294/c të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur lejimin e metodës speciale të hetimit Dorëzimit të Kontrolluar.
- 12.48 Neni 294/c i Kodit të Procedurës Penale “**Dorëzimi i kontrolluar**” përcakton se:
1. Dorëzimi i kontrolluar autorizohet nga prokurori që drejton hetimet paraprake, me kërkesë të autoriteteve të huaja.
  2. Dorëzimi i kontrolluar mund të autorizohet në rastet e mëposhtme:
    - a) kur personat që dyshohet se janë përfshirë në transportin e paligjshëm të lëndëve narkotike, armëve, sendeve të vjedhura, materialeve eksplozive ose bërthamore, materialeve radioaktive, shumave të parave dhe të ardhurave të tjera produkte të veprës penale ose të sendeve të përdorura si mjet për kryerjen e veprave penale, nuk mund të identifikohen ose arrestohen në mënyra të tjera, si dhe kur identifikimi apo arrestimi i tyre do të dëmtonte hetimet ose do të rrezikonte sigurinë e personave apo dëmtimin ose humbjen e sendeve që transportohen;
    - b) kur zbulimi i veprave penale dhe marrja e provave është i pamundur ose i vështirë për t'u kryer në mënyra të tjera.
- 12.49 Sipas Udhëzimit të Përbashkët për Përdorimin e Metodave Speciale të Hetimit të Krimeve kundër Drogës, të miratuara më datë 11.04.2003 nga Prokuroria e Përgjithshme dhe datë 09.04.2003 nga Ministria. Sipas këtij udhëzimi përcaktohet se **Metodat Speciale të Hetimit kanë për qëllim gjurmimin, identifikimin dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale të gjithë personave (korrierëve, blerësve, organizatorëve, financuesve etj.) dhe/ose organizatave kriminale të përfshira në trafikun e organizuar ndërkombëtar të lëndëve narkotike.**
- 12.50 **Dorëzimi i kontrolluar, sipas vendit që realizohet mund të jetë:**
- a) “i brendshëm” kur pika e nisjes dhe destinacioni i një ngarkese me lëndë narkotike, psikotrope ose prekursorëve të tyre është brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.
  - b) **"Në hyrje", kur ngarkesa me këto lëndë është konstatuar dhe nisur nga një vend i huaj me destinacion për në Shqipëri.**
  - c) **"Në dalje"** kur ngarkesa nisët nga territori Shqiptar dhe destinacioni i saj janë



shtete te tjera:

- 12.51 Metoda e dorëzimit të kontrolluar përveç çfarë është parashikuar në piken 3 të këtij Udhëzimi të Përbashkët, përdoret vetëm kur realizohet sigurimi i kontrollit të plotë e të vazhdueshëm i ngarkesës së lëndës narkotike, psikotrope ose prekursorëve të tyre. **Me miratim të prokurorit përgjegjës në fillim të përdorimit të dorëzimit të kontrolluar dhe kur mendohet se ekzistojnë mundësitë se ngarkesa mund të humbasë nga kontrolli, mund të kryhet zëvendësimi i saj me lëndë të tjera.**
- 12.52 Nga analiza që na jep ky Udhëzim rezulton që kemi pasur një Dorëzim të Kontrolluar “Në hyrje” pasi lënda narkotike është konstatuar që ka ardhur nga një vend i huaj me destinacion për në Shqipëri. Argumenti i përdorur nga ana e organit të akuzës se operacioni është ndërprerë për shkak të kushteve atmosferike, pozicionimit të magazinës apo mundësisë të humbjes së lëndës narkotike nuk mund të qëndrojnë si arsye ligjore për më tepër në bazë të argumenteve dhe fakteve ligjore si më poshtë.
- 12.53 Nuk mund të argumentojë organi i akuzës pamundësinë e kryerjes së hetimit për shkaqe natyrore apo pamundësi kontrollimi dhe mos realizimi i këtyre fakteve dhe zbulimi i të vërtetës duhet të shkojnë në favorin e organit të akuzës duke rënduar pozitën e të pandehurit. Jo, organi akuzës është një aparat i krijuar posaçërisht për hetimin dhe zbulimin e krimeve dhe veprave penale dhe kjo strukturë përveçse strukturës dhe logjistikës që ka, asistohet edhe nga të gjitha forcat e rendit, policisë apo forcave speciale në Shqipëri dhe çdo aparat tjetër i Administratës Publike.
- 12.54 *Vlerësimi i Gjykatës së GJEDNJ-së në çështjen Xheraj. "Gabimet e autoriteteve shtetërore duhet të interpretohen vetëm në dritën e asaj çfarë është në dobi të të pandehurit. Me fjalë të tjera, risqet në lidhje me gabimet e autoritetit të akuzës, apo të gjykatës, duhen përballuar nga shteti, dhe riparimi i tyre nuk duhet të rëndojë pozitën e të pandehurit të akuzuar (vendimi Radchikov kundër Rusisë, § 50).*
- 12.55 **Organi i akuzës nëse nuk kishte një plan operacioni dhe vlerësonte që kushtet atmosferike nuk e lejonin apo pretendime të tjera mund të kishte vepruar duke mos e lejuar nxjerrjen e kontejnerit duke urdhëruar lejimin e daljes së tij ditën e nesërme kur ti kishte të gjithë mundësit e zhvillimit të operacionit. Organi i akuzës identifikimin e Donaldo LUSHAJ dhe Armando PEZAKUT e kishte konstatuar që në momentin që ata janë paraqitur në Portin e Durrësit për kryerjen e veprime që ata kishin si detyra për shkak të punës së tyre. Pra nëpërmjet këtij veprimi hetimor organi akuzës nuk morri asnjë të dhënë të ndryshme si për të pandehurin Donaldo LUSHAJ por edhe për shoferin Armando PEZAKU. Gjithashtu nuk rezulton ndonjë provë shkresore e prokurorit apo të ndonjë funksionari të policisë të cilët shprehin mendimin dhe vlerësimin e se nuk**

- janë kushtet e përshtatshme për të ndërhyrë. Nga ana e policisë nuk asnjë plan veprimi për të përcaktuar mënyrën, kushtet dhe rrethanat për të ndërhyrë apo të ketë një plan të magazinës.
- 12.56 Gjykata Evropiane shpesh është shprehur se nuk i përket asaj të ndërrojë pikëpamjen e saj përse i përket pranueshmërisë dhe provueshmërisë së provave me atë të gjykatave vendase, megjithëse ka shqyrtuar mënyrën në të cilën trajtohen provat si një çështje e rëndësishme në marrjen e vendimin nëse një gjyq ka qenë i drejtë apo jo.<sup>2</sup> Rregullat e provave kështu kryesisht i përkasin si çështje gjykatave vendase në çdo Shtet Kontraktues. Megjithatë Konventa ka përcaktuar disa udhëzues të rëndësishëm për mënyrën e marrjes dhe vlerësimit të saj kur në thelb ajo ka vendosur apo kërkohet të vendoset dënimi mbi bazën e atyre provave.
- 12.57 Parimi i Thashethemeve si Prova<sup>3</sup> në parim nuk është në kundërshtim me garancitë e procesit të drejtë, por nëse nuk ka mundësi për të bërë hetime kjo mund ta bëjë gjyqin të padrejtë nëse dënimi bazohet tërësisht ose kryesisht në prova të tilla. Organi akuzës në gjithë hetimin që ka kryer nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete nga ato të përcaktuara në nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale, por thjesht paraqet alibira, aludime dhe subjektivizma. Në bazë të ligjit penal material askush nuk mund të dënohet për një veprim ose mosveprim të parashikuar nga ligji si veprë penale, në qoftë se vepra nuk është e kryer me faj, sipas parimit të fajësisë së veprës penale; pra, (*nullum crimen, nulla actio sine culpa*). Quhet me faj personi që e kryen veprën me dashje ose me pakujdesi. Këto forma të zbatimit të parimit të fajësisë në të drejtën penale përbëjnë edhe qëndrimin psikologjik apo subjektiv që shfaq autori ndaj veprës penale dhe nuk mund të atribuohet veprimi kriminal në mënyrë objektive apo absolute pa pasur një lidhje psikologjike me anën objektive të veprës penale. Organi i akuzës nuk mund të shprehet se për shkak të pamundësisë së kushteve atmosferike dhe mos pasjes së një plani konkret ndërpreu hetimin special të ndërmarr me anë të Dorëzimit të Kontrolluar duke mos e lënë daljen e kontejnerit apo të priste momentin e ndërhyrjes në kontejner për nxjerrjen e lëndës narkotike.
- 12.58 Është fakt i provuar që në për hapjen e kontejnerit nga ana e forcave të policisë është kërkuar ndihma e zjarrfikësve për ta realizuar dhe ky proces ka kërkuar një periudhë kohore afërsisht pesë orë. Pra edhe pretendimi i organit të akuzës se lënda narkotike mund të humbiste bie.
- 12.59 Gjithsesi nëse organi i akuzës kishte frikën e humbjes së lëndës narkotike përse nuk veproi për zëvendësimin e saj ??? Përse për të gjitha këto veprime që nuk janë realizuar nga ana e forcave të policisë duhet të rëndohet pozita e të

<sup>2</sup> Van Mechelen dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulëta, 18 Mars 1977

<sup>3</sup> Blasland kundër Mbretërisë së Bashkuar

- pandehurve duke e kaluar barrën e provës nga ana e organit të akuzës tek të pandehurit, kur ligji përcakton se barrën e provës e ka organi i akuzës.
- 12.60 Nga kontrolli i ushtruar nga ana e forcave të policisë në ambientet e shoqërisë “Arbri Garden”, nuk është gjendur asnjë mjet prerës apo ndihmës i cili do të ngrinte qoftë edhe një dyshim të vogël, për faktin që ai do të shërbente për hapjen e kontejnerit fakt që tregon dhe provon që kontejneri nuk do të hapej në magazinat e shoqërisë Arbëri Garden.
- 12.61 Faktin që lënda narkotike nuk do të hapej në magazinën e shoqërisë Arbëri Garden e konfirmojnë dhe prania funksionimit të kamerave të instaluar në magazinë. Nëse do të pranojmë alibinë e ngritur nga ana e organit të akuzës se lënda narkotikësh do të hapej brenda magazinës së Arbri Garden, atëherë minimalisht bashkëpunëtorët e pretenduar në këtë veprimtari Donald LUSHAJ dhe Armando PEZAKU, veprimin e parë që do të kishin realizuar kur u futën në magazinë do të kishte qenë fikja e kamerave të cilat do të regjistronin hapjen e kontejnerit.
- 12.62 Gjykata dhe organi i akuzës pretendojnë dhe ngrejnë alibinë se “gjatë kësaj periudhe i pandehuri Donald mban komunikime me Arbër ÇEKAJ, ndodhur në Gjermani dhe flasin ndër të tjera se ai (Arbri) ishte pronari i mallit dhe se e kishin kërkuar në port dhe Arbëri i thotë t’iu thonte se ishte në Gjermani (duke ju përgjigjur Arbëri Donaldit në komunikim fillimisht me bababa). Edhe në këtë moment prokurori nuk i tregon gjykatës se cila është kjo bisedë e transkriptuar, çfarë date mban, çfarë nr. transkriptimi dhe pse nuk e paraqet të gjithë bisedën !!! Transkriptimi i bisedës i paraqitet gjykatës për ta vlerësuar me cilësinë e provës e plotë dhe në kontekst siç është e zhvilluar dhe jo duke shkëputur apo pjesë nga ajo për ta paraqitur me alibinë se (hahahahaha) qenka një provë kategorike e cila provon dijeninë e të pandehurit Arbër ÇEKAJ për sasinë e kokainës. Është e qëllimshme prandaj organi i akuzës nuk paraqet asnjë identifikim të transkriptimit të kësaj bisede, çfarë date ? çfarë ore? Çfarë nr. transkriptimi mban ??.
- 12.63 Nëse do të referohemi transkriptimit të bisedës që organi akuzës e përdor në mënyrë jo korrekte pavarësisht se ka detyrimin ligjor sipas nenit 8/a të Kodit të Procedurës Penale. Biseda e datës 27.02.2018.
- Donald** Nr.85234, 27/02/2018 13:59:16: CA BANE ?;
- Arbër** Nr. 85236 27/02/2018 13:59:28: HIC;
- Arbër** Nr. 85238 27/02/2018 13:59:41: KA LEXOJ SALI BERISHËN;
- Arbër** Nr. 85240 27/02/2018 13:59:43: HAHA;
- Donald** Nr.85242, 27/02/2018 14:00:11: FRUTAT PO SHKARKOHEN NJËRI E TRJETRIN MË THIRRI LINDI QË DUAN TA KONTROLLOJNË E MORA DY PUNTORË KA NISËM ME SHKU;

- Donaldo Nr. 85245, 27/02/2018 14:00:14: HAHA;  
Arbër Nr.85246, 27/02./2018, 14:00:33: OK
- 12.64 Pra nga konteksti i bisedës del shumë qartë që komunikimi nuk ka pas atë ngjyrim që i ka dhënë organi i akuzës por thjeshtë një bisedë normale dhe e qeshura HAHA ka qenë në sajë të përgjigjes që Arbëri i ka dhënë Donaldos duke i thënë që po lexonte Sali Berishën...
- 12.65 Së dyti, Në përmbajtjen e nenit Neni 28/4 të Kodit Penal, i jep “Grupit të strukturuar kriminal” si formë e veçantë bashkëpunimi, e cila, në mënyrë që të ekzistojë, duhet të rezultojnë të provuar, disa elementë juridikë, të cilat çmohen të trajtohen, në mënyrë të përmbledhur, duke u sqaruar fakti që i pandehuri Arbër ÇEKAJ nuk është pjesë e ndonjë grupi të strukturuar kriminal, nuk apo të ketë kryer ndonjë vepër penale si pjesëmarrës në grupin kriminal.
- 12.66 “Grupi i strukturuar kriminal”, si formë e veçantë bashkëpunimi, është parashikuar nga pika 4 e nenit 28 të Kodit Penal, e cila parashikon:  
*“Grupi i strukturuar kriminal është formë e veçantë bashkëpunimi, në të cilin bëjnë pjesë tre ose më shumë persona, për kryerjen e një a më shumë veprave penale, për të realizuar përfitime materiale dhe jo materiale. Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një veprë penale nuk formohet rastësisht e nuk është e nevojshme të dallohet për anëtarësi të qëndrueshme, ndarje detyrash, organizim dhe strukturim të zhvilluar”.*
- 12.67 Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr 3/2011, fq 21, përcakton shprehimisht se “*në kushtet kur vepra penale e trafikimit është kryer nga dy ose më shumë persona, pavarësisht llojit të veçantë të bashkëpunimit, duhet të individualizohet për secilin bashkëpunëtor mënyra konkrete e kryerjes së veprës penale*”.
- 12.68 Në këtë rast, është detyrim i gjykatës dhe organi i akuzës të provonin “*përtej çdo dyshimi*” ekzistencën e marrëveshjes kriminale ndërmjet Arbër ÇEKAJ dhe personave të tjerë të akuzuar nga organi i akuzës, marrëveshje në të cilën duhet të provohet se Arbër ÇEKAJ ka hyrë me ndërgjegje dhe vullnet për të kryer vepër penale si dhe me ndërgjegjen dhe dëshirën për të bashkëpunuar me personat e tjerë për kryerjen e saj dhe arritjen e pasojave kriminale.
- 12.69 Gjykata duhet të arsyetonte dhe organi i akuzës duhet të provonte, kur ka lindur kjo marrëveshje, ndërmjet kujt personave, kur ka hyrë Arbër ÇEKAJ, Donaldo LUSHAJ dhe Armando PEZAKU në këtë marrëveshje, në fillim, në mes apo në fund. Të gjitha këto, gjykata dhe organi i akuzës kanë detyrimin kushtetues e ligjor, ti provojë “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”.

12.70 Duke u nisur nga përcaktimi që ligji i ka bërë “*Grupi i strukturuar kriminal*”, si formë e veçantë bashkëpunimi, çmojmë se për të qenë para kësaj forme bashkëpunimi, duhet të ekzistojë disa elementë juridikë:

a) *Grupi i strukturuar kriminal formohet nga bashkëpunimi i të paktën tre ose më shumë personave, bashkëpunim i cili bëhet me qëllim kryerjen e një ose disa veprave penale.* Për të qenë para grupit të strukturuar kriminal kërkohet që të ekzistojë bashkëpunimi për kryerjen e një ose disa veprave penale, të paktën ndërmjet tre personave, në rast të kundërt, në qoftë se, bashkëpunimi ekziston vetëm ndërmjet dy personave, nuk mund të jemi para grupit të strukturuar kriminal, por para formave të tjera të bashkëpunimit. **Në rastin konkret nuk del e provuar nga asnjë provë se i pandehuri Arbër ÇEKAJ të ketë bashkëpunuar me Donaldo LUSHAJ apo me shoferin e kamionit Armando PEZAKU në kryerjen e veprës penale të trafikimit të narkotikëve.** Në referim të dispozitës së cituar më lart, për të qenë para kryerjes së veprës apo veprave penale nga ana e grupit të strukturuar kriminal kërkohet që të ekzistojnë njëkohësisht të gjitha kushtet e përshkruara në përmbajtjen e saj. Ballafaquar me provat e administruara në gjykimin konkret në ngarkim të shtetasit Arbër ÇEKAJ, organi i akuzës ka paraqitur tre persona si të dyshuar por nuk ka provuar me prova bindëse tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri Arbër ÇEKAJ, së pari, ka qenë në dijeni të lëndës narkotike në kontejner, së dyti, ai të ketë bashkëpunuar për nxjerrjen e drogës nga kontejneri, së treti, nuk provohet bashkëpunimi për qëllim fitimi ekonomik, së katërti, por nuk provohet elementi thelbësor i kësaj figure që është “*mos formimi rastësisht*”, së pesti, nuk provohet që të ketë pasur ndonjë kontakt me shoferin Armando PEZAKU. **Është fakt i provuar edhe nga provat shkresore se nuk rezulton e provuar që ky i pandehur të ketë pasur njohje të mëparshme me shoferin e kamionit Armando PEZAKU, fakt i cili del si nga deklarimet e personave Armando PEZAKU, Ermir MALIQATI, Genci MATAJ, Fatos LALA, Donaldo LUSHAJ, Besnik DERVISHI, Nuredin SEFERI, Selman DASHI, Majlind DERVISHI, Edmond LOLA, Nuredin SEFERI, Elis TAHIRAJ, Asllan DOMI dhe Besmir MARGJEKA. Por edhe nga provat shkencore si Akt Ekspertimi i telefonit të të pandehurve etj.**

b) *Grupi i strukturuar kriminal për kryerjen e një ose disa veprave penale, me qëllim realizimin e përfitimeve materiale ose jo materiale, nuk formohet rastësisht.* Kjo do të thotë se, për të qenë para kësaj forme të bashkëpunimit të veçantë, kërkohet që ky bashkëpunim të ketë ekzistuar, paraprakisht, që para se të fillojë kryerja e veprës penale, dhe ky bashkëpunim të ekzistojë edhe në momentin e fillimit të kryerjes së veprës penale dhe gjatë gjithë kohës së kryerjes së veprës penale. **Edhe në këtë kriter absolut i nenit 28/4 gjykata dhe organi i akuzës nuk kanë vërtetuar apo cilësuar se cili ka qenë momenti dhe cila është prova konkrete që cilëson apo provon ekzistencën e bashkëpunimit të pandehurit Arbër ÇEKAJ me të pandehurit e tjerë apo që ky bashkëpunim ka vazhduar me veprime konkrete edhe në vazhdim (tentativa për të hapur kontejnerin).** Pretendimi i organit të akuzës qëndron vetëm në nivel dyshues, i pa

bazuar në prova konkrete të dala nga hetimi, por provon fakte të njohura që nuk kishin nevojën e hetimit. Fakti që Donaldo LUSHAJ ishte i punësuar pranë shoqërisë Arbri Garden është një fakt që s'ka dal nga hetimi por ishte fakt i njohur, fakti që Arbër ÇEKAJ komunikonte për çështje të punës me Donaldo LUSHAJ është një fakt që s'ka dal nga hetimi por është fakt i njohur nga vetë natyra e punës dhe është një normë normale në një shoqëri demokratike ku punonjësi të ketë komunikime me eprorin e tij.

Në rastin konkret nga hetimi, nuk është vërtetuar që të ketë ekzistuar një organizim dhe strukturim i caktuar dhe ndarja e roleve të krijuesit, shtytësit dhe ekzekutorët në këtë grup. Nuk mund të ketë grup të strukturuar kriminal dhe kryerje të veprave prej tij pa një krijues dhe drejtues dhe pa një organizim dhe strukturim të caktuar sado minimal. Ekzistenca e një strukture dhe një organizimi për kryerjen e veprës penale, tek grupi i strukturuar kriminal, është një nga elementët kryesorë që e dallon këtë formë bashkëpunimi të veçantë nga bashkëpunimi i thjeshtë.

Në rastin konkret, nga analiza e rrethanave të faktit dhe anës objektive të kësaj figure veprë penale, ka rezultuar se të gjithë bashkëetëgjykuarit janë mbledhur (formuar) rastësisht për shkak të punës së përditshme të tyre. Pra Donaldo LUSHAJ ditën e ngjarjes ka kryer një punë që e ka kryer edhe herë të tjera dhe nuk ka qenë një veprim pune që e ka kryer për herë të parë dhe për rastin konkret. Donaldo LUSHAJ në mungesë të pronarit të tij dhe në kushtet kur është kërkuar nga ana e Agjentit Doganor, ka shkuar gjithmonë në Portin e Durrësit për shkak të kontrolleve që është pjesë rutine dhe normale e aktivitetit. Gjithashtu edhe prezenca e të pandehurit tjetër Armando PEZAKU ditën e ngjarjes në Portin e Durrësit ka qenë për shkak të punës së tij të përditshme dhe nuk ka qenë një veprim që është kryer vetëm atë ditë.

Vërtetohet e kundërta, që Arbër ÇEKAJ nuk ka as njohje, as marrëdhënie, as raport rastësor e as të qëndrueshëm, me Armando PEZAKUN ndërsa me të pandehurin tjetër Donaldo LUSHAJ marrëdhënia është për shkak të raporteve të punës dhe me cilësinë e punëdhënësit dhe punëmarrësit. Përderisa vërtetohet se Arbër ÇEKAJ nuk ka asnjë kontakt personal me të akuzuarin Armando PEZAKU, nuk ka asnjë rrethanë se si mund të ketë dhënë porosi apo këshillë në lidhje me aktivitetin e paligjshëm të trafikimit të lëndës narkotike siç pretendon organi i akuzës, në një grup të strukturuar kriminal të qëndrueshëm dhe me aktivitet të shtrirë në kohë mbi fakte të aluduara dhe aspak të mbështetura në prova ligjore.

c) *Grupi i strukturuar kriminal, si formë e veçantë bashkëpunimi, duke qenë se kërkon një organizim dhe strukturim të caktuar minimal, nënkupton që, midis anëtarëve të grupit, të ekzistojë një ndarje rolesh dhe detyrash minimale, ku një ose disa anëtar të jenë organizator dhe të tjerët të jenë në rolin e ndihmësit, shtytësit apo ekzekutorit, edhe pse kjo ndarje detyrash nuk është e zhvilluar.* Ky element i

grupi të strukturuar, përcaktimi i bërë nga ky paragraf i referohet një ndarje të detyrave, e cila është e zhvilluar, në kuptimin që ka gjithmonë një drejtues, i cili është i tillë në mënyrë të qëndrueshme dhe një ose disa persona të cilët janë të varur prej tij ndjekin dhe zbatojnë urdhrat e tij. Por është e domosdoshme që të ekzistojë gjithmonë një ndarje minimale detyrash, në kuptimin që duhet gjithmonë të ketë një organizator dhe një ose disa persona të tjerë që të veprojnë si ekzekutorë, shtytës apo ndihmës. **Në këto kushte mund të konkludojmë se, pa pasur një ndarje minimale detyrash dhe rolesh, ndërmjet bashkëpunëtorëve për kryerjen e veprës penale, nuk mund të jemi para grupit të strukturuar kriminal, për rrjedhojë ky moment nuk arrihet të provohet nga ana e organit të akuzës për të pandehurin Arbër ÇEKAJ. Organi i akuzës e paraqet rolin e të pandehurit Arbër ÇEKAJ me cilësinë e organizatorit dhe sipas nenit 26 të Kodit Penal organizatori është figura kryesore në organizatën kriminale. .**

Organizatori është personi i cili fton personat e tjerë për realizimin e veprës penale. Ai është personi i cili zgjedh dhe rekruton bashkëpunëtorë. Kryerja e veprës penale në bashkëpunim, kërkon dy ose më shumë persona, kështu që detyra e parë në këtë rast është gjetja e personave të nevojshme që merren me kryerjen e veprës penale, kjo detyrë është atribut ekskluzive i organizatorit, i cili merret me rekrutimin apo gjetjen e personave të përshtatshëm, të cilët më pas do t'i përfshijë në veprimtarinë kriminale. Nga hetimi nuk provohet me asnjë provë të drejtpërdrejtë apo edhe indicie se cila ka qenë mënyra për përzgjedhjen dhe futjen e shoferit Armando PEZAKU në Grupin e Strukturuar Kriminal si një kriter i cili kërkohet nga vetë ligji por edhe Konventa e Palermos. Nga vetë organi i akuzës, pretendimin e përfshirjes së shoferit Armando PEZAKU në Grupin e Strukturuar Kriminal e aludon duke përcaktuar Donald LUSHAJ dhe Edmond LOLËN në përzgjedhjen e tij. Pra organi i akuzës pavarësisht se e njih ligjin dhe e di se në grupin e strukturuar kriminal është organizatori ai i cili fton dhe përzgjedh personat e tjerë për realizimin e veprës penale këtë rol ja vesh në mënyrë të qëllimtë të pandehurit Arbër ÇEKAJ. Për më tepër në konkluzionet e tij ai shprehet dhe pretendon që Edmond LOLA ka ndihmuar në përzgjedhjen e shoferit, por ai nuk është pjesë e grupit të strukturuar kriminal por as nuk është një person i akuzuar.

Nga ana e organit të akuzës por edhe hetimit në asnjë moment nuk analizohet mënyra se si e ka ngarkuar i pandehuri Arbër ÇEKAJ lëndën narkotike, kryerjen e një analize ekonomike nëse ky i pandehur duke qenë se sipas organit të akuzës kishte rolin e organizatorit a kishte mundësin për blerjen e një sasive prej 613 kilogram Kokaine !!! A kishte udhëtuar i pandehuri në harkun kohor nga momenti i porositjes së mallit banane në shtetin Kolumbian !!! A kishte mundësi ligjore që ky i pandehur të dinte numrin e kontejnerëve që do të ngarkoheshin me banane nga shoqëria Baccota në Kolumbi !!! Përse nuk e përmend organi i akuzës faktin që kontejnerët nuk dalin nga porti Turbo pa kontrollin dhe

### Certifikimin nga ana e Policisë së Anti Narkotikut Kolumbian !!!

Nga provat dhe faktet ligjore rezulton e provuar se kontejnerët caktohen vetëm nga shoqëria CMA CMG dhe mbushja e tyre realizohet nga shoqëria Banacol, shoqëri këto të cilat nuk kanë asnjë lidhje me shoqërinë Arbri Garden. Pasi shoqëria porosit bananet tek shoqëria Baccota, kjo e fundit i dorëzon në portin Turbo i cili administrohet nga shoqëria Banacol dhe çdo veprim tjetër për ngarkimin e tyre në kontejner dhe në anije kryhet vetëm nga kjo shoqëri dhe shoqëria CMA CMG.

Por nga provat rezultojnë të provuara faktet që i pandehuri Arbër ÇEKAJ gjatë periudhës që është ngarkuar malli banane por edhe më përpara nuk ka qenë në Kolumbi, rezulton i provuar fakti që Arbër ÇEKAJ nuk ka dhe nuk ka pasur mundësi financiare për të blerë sasinë prej 600 kilogram kokainë i cila ka një vlerë mesatare rreth 50 milion Euro, rezulton i provuar fakti që Arbër ÇEKAJ nuk e ka ditur se cilët do të ishin kontejnerët që ishin caktuar për të ngarkuar mallin e tij banane pasi kjo varej vetëm nga shoqëria CMA CMG Kolumbi apo Banacol fakt ky i vërtetuar edhe nga dëshmia e administratorit të shoqërisë CMA CMG Albania Ermir MALIQATI, faktin që kontejnerët janë kontrolluar nga Policia e Anti Narkotikut Kolumbian.

Ky fakt vërtetohet edhe nga aktet shkresore Bill of Landing e cila është i vetmi dokument i cili përmban edhe të dhënat e kontejnerit për numrin e tij i cili i është dërguar shoqërisë Arbri Garden vetëm një javë më vonë pasi ngarkesa ishte ngarkuar nga porti Turbo në Kolumbi.

Rezulton e provuar edhe nga vetë e-maili që ka dërguar përfaqësuesi më i lartë i shoqërisë CMA CMG me seli në Marsejë ku ka shpjeguar detajet e kontejnerit frigoriferik me numër GESU9449548“ Kontejnerët frigoriferik shkarkohen në Kolumbi, zëkonishtë bosh dhe lëshohen tek CFS (Compania Fruitera de Sevilla LLC), një nën kontraktues i shoqërisë Banacol, i ngarkuar për marrjen në posedim të kontejnerëve të zbrazët dhe duke i përgatitur ato për mbushjen e bananeve. Kontejneri GESU9449548 u shkarkua nga HSL Nike më datë 02.01.2018 dhe u dorëzua në CFS në orën 22:30 dhe që nga ai moment kontejneri ishte nën kujdestarinë e vetme dhe përgjegjësinë e CFS/Banacol. CFS inspektoi kontejnerin më datë 04.01.2018 dhe riparimet e vogla u kryen në kontejner më datë 09.01.2018 (duke zëvendësuar 11 vidat e humbura në aparatit avullues). Këto riparime u faturuan 58,29 dollarë. Më datë 04.01.2018 CMA CMG Kolumbi mori një rezervim për ngarkimin e dy kontejnerëve nga Turvbo në Durrës për kompaninë eksportuese Baccota SAS. Rezervimet u pranuan nga CMA CGM Kolumbi dhe dy kontejnerët u mbushën nga shoqëria Banacol.”

Nga provat por edhe nga hetimi rezulton se i pandehuri Arbër ÇEKAJ nuk mund të ketë qenë në dijeni të numrit të kontejnerëve, nga provat nuk rezulton që ai të ketë komunikuar me ndonjë person për blerjen e lëndës kokainë, nga provat nuk



- rezulton që ai të ketë marrëdhënie bashkëpunimi me shoqërinë CMA CMG Kolumbi apo shoqërinë Banacol apo CFS të cilat janë shoqëri që bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për caktimin e kontejnerit dhe sigurinë e tij, nuk rezulton e provuar që i pandehuri Arbër ÇEKAJ të ketë paguar për riparimin e kontejnerit atje, fakt ky që fshihet nga organi i akuzës por edhe shoqëria CMA CMG pasi këto janë shërbime që paguhen nga ata si pronarë të kontejnerit.
- 12.71 Nisur nga elementët juridikë që duhet të përmbajë “Grupi i strukturuar kriminal”, si formë e veçantë bashkëpunimi, vlerësojmë duke analizuar për sa më sipër se, bashkëpunimi ndërmjet të gjykuarve dhe të pandehurit në rolin e organizatorit, nuk arrihet të provohet me asnjë prej provave të administruara nga gjykata, në kryerjen e veprave penale të “Trafikimi i narkotike”, “Grupi i strukturuar kriminal”, “Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 283/a 4, 333/a/2, 334/1, të Kodit Penal, nuk provohet, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se është realizuar sipas kësaj forme të veçantë bashkëpunimi.
- 12.72 **Së treti**, rezulton se nga të gjithë provat e administruara nga gjykata, ato nuk vërtetojnë konkluzionin përfundimtarë, pra të vërtetojnë fakte relevante në provimin e akuzave të ngritur nga organi i akuzës.
- 12.73 **Në nenin 13 të KP në të cilin parashikohet se:**
- Askush nuk ka përgjegjësi penale kur midis veprimit ose mosveprimit të tij dhe pasojave apo mundësisë së ardhjes së tyre mungon lidhja shkakësore...*
- 12.74 **Organi i akuzës, nuk ka vlerësuar, në respektim të drejtë të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale askush nuk mund të deklarohet fajtor me një provë të vetme qoftë edhe kur ajo është shkencore<sup>4</sup>, pasi pranimi i së kundërtës, do t’i hapte rrugë një arbitrariteti, me pasojë shkeljen e të drejtave të individit në procesin penal dhe që pa prova, individë të akuzuar për veprë penale të deklarohen fajtorë dhe të vuajnë një dënim të padrejtë.**
- 12.75 **Problemi i të provuarit të akuzës është themelor për çdo poçes dhe kjo kërkon një analizë të plotë e të gjithanshme të provave që paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor duke mënjanuar mbivlerësimin e çdo prove, gjë që do të dëmtonte procesin gjyqësor. Nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një veprë penale vetëm me një provë çfarëdo qoftë ajo edhe nëse është shkencore, nëse nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë. Nuk mund të ketë për**

<sup>4</sup> Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Latë Nr. 00-2017-1 i Vendimit (2), datë 18.01.2017.

- gjykatën asnjë provë me vlera të paracaktuara e që t'a mbështesë vendimin e fajësisë apo pafajësisë vetëm me një provë pa u harmonizuar ajo me prova të tjera.
- 12.76 Në procesin penal prokurori ka barrën e provës, çka do të thotë se nuk mjafton thjeshtë përmendja e faktit objekt akuze apo përmendja e pasojës së ardhur, por kërkohet dhënia e elementeve të tilla provuese, në mënyrë që gjykata të krijojë bindjen e saj në lidhje me bazueshmërinë dhe besueshmërinë e akuzës, lidhur me rrjedhën e fakteve dhe lidhjen e veprimeve me pasojën.
- 12.77 Megjithatë, ligji procedural lejon edhe vlerësimin e indicieve rreth ekzistencës një fakti, por me kusht që “indiciet” të jenë të shumta, të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën, sipas nenit 152/2 të Kodit të Procedurës Penale.
- 12.78 Në rastin konkret organi i akuzës vetëm ka përmendur faktet objekt akuze dhe pasojën e ardhur nga vepra penale, pa provuar në mënyrë sistematike lidhjen e të pandehurit Arbër ÇEKAJ me të pandehurit e tjerë dhe lidhjen e tyre për formimin e grupit të strukturuar kriminal. **Pra organi i akuzës nëpërmjet indicieve apo provave duhet ti provonte gjykatës duke analizuar në mënyrë korrekte dhe të pakundërshtueshme faktin që Arbër ÇEKAJ kishte dijeni për lëndën narkotike që ndodhej në kontenier, ai kishte mundësinë reale ekonomike të blerjes së prej 600 kilogram kokain dhe ai me veprime konkludente ka kryer veprime në kundërshtim me ligjin sëbashku me Donaldo LUSHAJ dhe Armando PEZAKU. Faktet që përpiqet dhe mundohet ti pareqes me cilësinë e indicieve organi i akuzës janë dhe ishin fakte të njohura përpara dhe nuk kanë dalë si rezultat i hetimit. Fakti që kontejneri ishte porositur nga shoqëria Arbëri Garden dhe do të shkarkonte në magazinat e kësaj shoqërie bananet nuk është një indicie që tregon se ai ka pasur dijeni për lëndën narkotike por është një fakt i ngjarë për shkak të rrethanave të aktivitetit tregtarë që kjo shoqëri realizon. Fakti penal do të kishte qenë i hetuar nëse do të ishte lënë nga ana e organit të akuzës shkarkimi i bananave deri në fund duke parë nëse kontejneri do të dilte nga magazinat e shoqërisë Arbëri Garden apo jo.**
- 12.79 Pra cila ishte ajo provë e administruar dhe e vlerësuar nga gjykata e cila na provon se i pandehuri Arbër ÇEKAJ kishte dijeni për lëndën narkotike apo njohje shoqërore me të pandehurin tjetër Armando PEZAKU. Organi akuzës këtë moment nuk e paraqet fare dhe as e analizon.
- 12.80 Në konkluzionet e paraqitura nga ana e organit të akuzës referohet se “*shtetasi Arbër ÇEKAJ gjatë kohës që kontejneri mbahet në doganën e Durrësit, mbante komunikime të shpeshta dhe i shqetësuar me të pandehurin Donaldo Lushaj*”. Siç rezulton shqetësimet e të dy të pandehurve lidhen me “Anti Narkotikun”, pra me kontrolllet që lidhen pikërisht me lëndët narkotike, shprehet organi i akuzës në konkluzionet e tij.

- 12.81 Ndërkohë nga provat konkrete ku është transkriptuar dhe kjo bisedë që përdoret nga ana e organit të akuzës në mënyrë të qëllimtë dhe në kontekst të kundërt duke fshehur faktin që Donaldo LUSHAJ atë ditë i është kërkuar nga ana e punonjësit të Narko Trafikut të komunikojë me Arbër ÇEKAJ dhe nga komunikimi dhe transkriptimi i bisedës të zhvilluar midis Arbër ÇEKAJ dhe Donaldo LUSHAJ në aplikacionin Ëhats Up, del qartësisht i provuar fakti që Donaldos i është kërkuar nga punonjësit e policisë numri i telefonit të Arbrit, i cili e ka vendosur në dispozicion dhe është realizuar komunikimi telefonik midis oficerin të policisë së Anti Narkotikëve dhe Arbër ÇEKAJ.
- 12.82 Nga transkriptimi i drejtë i bisedës del qartë komunikimi si më poshtë:  
 Donaldo 27/02/2018 17:52:35: Po më kërkojnë nr tëndë;  
 Donaldo 27/02/2018 17:52:45: Tju jap këtë  
 Arbër 27/02/2018 17:53:10: Po  
 Arbër 27/02/2018 17:53:19: ky në Ëhat Up  
 Arbër 27/02/2018 17:54:37: 004917620027457  
 Arbër 27/02/2018 17:54:44: ky është telefoni  
 Arbër 27/02/2018 17:55:01: ndërsa në Ëhats up është ky që po të shkruaj.  
 Arbër 27/02/2018 17:55:12: është zhvilluar një bisedë midis punonjësit të policisë dhe Arbër ÇEKAJ e cila ka zgjatur 00:02:46 por nuk është transkriptuar me qëllim nga ana e prokurorit dhe oficerëve të policisë gjyqësore.
- 12.83 Në këtë bisedë e cila ka zgjatur dy minuta e dyzetë e gjashtë sekonda (02:46) është komunikuar nga ana e oficerit të Anti Narkotikut, i cili i është prezantuar Arbër ÇEKAJ për funksionin e tij dhe e ka pyetur se ku ndodhej...
- 12.84 Rrjedha e bisedës së mësipërme të transkriptuar vazhdon si më poshtë:  
 Arbër 27/02/2018 18:09:36: Çfarë problemi ka;  
 Donaldo 27/02/2018 18:10:09: Se di akoma spo me thonë;  
 Arbër 27/02/2018 18:10:27: Ok  
 Arbër 27/02/2018 18:10:39: A i morët frutat  
 Arbër 27/02/2018 18:10:47: Apo akoma ?  
 Donaldo 27/02/2018 18:11:12: jo jo janë shkarkuara jashtë frutat e ne po presim këtu te gjithë.  
 Arbër 27/02/2018 18:11:26: Ok  
 Arbër 27/02/2018 20:24:48: o vlla mbaruat  
 Arbër 27/02/2018 20:24:58: se ju lanë aty  
 Arbër 27/02/2018 20:25:33: je që në mëngjes në punë;  
 Donaldo 27/02/2018 21:18:16: jo me këtu jemi akoma  
 Donaldo 27/02/2018 21:18:34: i ngarkuam  
 Arbër 27/02/2018 21:18:35: Pse o vlla

**Arbër** 27/02/2018 21:18:40: Çfarë kanë  
**Donaldo** 27/02/2018 21:18:43: e po presim te japin ok që të dalim  
**Arbër** 27/02/2018 21:18:52: A janë normal  
**Arbër** 27/02/2018 21:18:59: 12 ore aty  
**Donaldo** 27/02/2018 21:19:23: le se jemi ngrire  
**Arbër** 27/02/2018 21:19:35: ma bëni hallall  
**Donaldo** 27/02/2018 21:19:42: ka presim jemi besoj mbarojmë për nja gjysmë ore  
**Donaldo** 27/02/2018 21:19:42: ko mo ca faji ke ti;  
**Arbër** 27/02/2018 21:19:57: se nuk isha vet aty;  
**Donaldo** 27/02/2018 21:19:59: po këta fisqira plera muti;  
**Arbër** 27/02/2018 21:20:16: po ku me e dite unë se çmenden ata kara;  
**Arbër** 27/02/2018 21:20:25: na kane marre inat;  
**Arbër** 27/02/2018 21:20:39: tatimet, këta spo kuptoje çfarë kane ?:  
**Donaldo** 27/02/2018 21:20:47: vari karin se për inat jan ka na e bëjnë për me marre  
Lek;  
**Arbër** 27/02/2018 21:21:02: asnjë leke mos jua jep;  
**Donaldo** 27/02/2018 21:21:09: asnjë kafe sja u dhamë;  
**Donaldo** 27/02/2018 21:21:13: se lek të harrojnë;  
**Arbër** 27/02/2018 21:21:14: nëse ju lanë nje muaj att  
**Arbër** 27/02/2018 21:21:20: kontrolloni thuaj;  
**Arbër** 27/02/2018 21:21:47: po për ditë me kontroll i kemi atje po aty po scanner te  
gjitha tani çfarë duan ma shumë;  
**Arbër** 27/02/2018 21:21:59: shtet koti;  
**Donaldo** 27/02/2018 21:22:09: shtet hajdut;  
**Arbër** 27/02/2018 21:23:14: ok më trego pra  
**Arbër** 27/02/2018 21:23:29: edhe a i ke punëtorët me shkarkue  
**Arbër** 27/02/2018 21:23:35: te puna  
**Donaldo** 27/02/2018 21:23:49: po te puna jane;  
**Arbër** 27/02/2018 21:23:35: ok;  
**Arbër** 27/02/2018 21:26:40: marrjau letrën e kontrollit;  
**Donaldo** 27/02/2018 21:27:19: po po;  
**Arbër** 27/02/2018 22:33:13: **A mbaruat akoma**  
**Donaldo** 27/02/2018 22:33:55: jo jo po presim me sjell letrat akoma  
**Arbër** 27/02/2018 22:34:14: a folët me ta  
**Arbër** 27/02/2018 22:34:24: a janë normal o vlla  
**Donaldo** 27/02/2018 22:34:38: ka presim me ardh te gjithë me firmos proces  
Verbalin;  
**Arbër** 27/02/2018 22:34:55: sjemi sklevër ku karrin janë;  
**Arbër** 27/02/2018 22:35:12: me i fut në gjyq;  
**Arbër** 27/02/2018 22:35:40: qënkan jo normal;  
**Donaldo** 27/02/2018 22:36:09: ishalla mbarojmë sonte njëher e vari karin se ca me

ju ba

Arbër 27/02/2018 22:36:09: pse thonë sbën sonte apo si  
 Donaldo 27/02/2018 22:36:47: po shkon ora 11;  
 Arbër 27/02/2018 22:36:57: e di;  
 Donaldo 27/02/2018 22:36:58: nuk të lënë me dalë pas orës 11;  
 Arbër 27/02/2018 22:37:07: po thirrju  
 Arbër 27/02/2018 22:37:12: po thuaju o vëlla;  
 Arbër 27/02/2018 22:37:17: cfarë po bëni;  
 Arbër 27/02/2018 22:37:22: me kënd je aty;  
 Donaldo 27/02/2018 22:37:28: skanë gjë në dorë këta;  
 Donaldo 27/02/2018 22:37:39: po presin me ardh nga tirana;  
 Arbër 27/02/2018 22:37:40: kush ka në dorë;  
 Donaldo 27/02/2018 22:37:47: me tosin jam;  
 Arbër 27/02/2018 22:37:52: me ardhë pse;  
 Arbër 27/02/2018 22:38:01: a e kontrolluan;  
 Arbër 27/02/2018 22:37:20: Ai që fola me të tha jam nga tirana;  
 Donaldo 27/02/2018 22:38:26: po po me firmos procesverbalin ata që ishin ne  
 Kontroll

Donaldo 27/02/2018 22:38:32: ata po presim që fole ti;

Arbër 27/02/2018 22:38:35: anti narkotiku;  
 Donaldo 27/02/2018 22:38:36: me ardh me firmos;  
 Arbër 27/02/2018 22:38:35: po a janë normal pse ikën pa firmos;  
 Arbër 27/02/2018 22:39:09: kush jua ka numrat;  
 Arbër 27/02/2018 22:39:21: nuk është Arlindi;  
 Donaldo 27/02/2018 22:39:42: jo ka ik Arlindi se njëherë thanë mbaruam;  
 Donaldo 27/02/2018 22:39:50: sdi është e ngatërrume;

- 12.85 Pra nga rrjedha e komunikimit del shumë i qartë që fakti nuk është ashtu siç mundohet ta serviri organi i akuzës se Arbër CEKAJ dhe Donaldo LUSHAJ kanë qenë të shqetësuar për Narko Trafikun por fakti qëndron se kanë qenë vetë këta të Narko Trafikut të cilët kanë ushtruar kontrollin e kontejnerit dhe nga ana e Donaldos i është dhënë dhe numri i telefonit të Arbërit pasi është kërkuar nga një prej oficerëve të policisë së Narko Trafikut për të komunikuar. Nga biseda del shumë qartë që Arbëri i ka dhënë numrin e telefonit Donaldos dhe pas këtij momenti siç del edhe transkriptimi i bisedës Arbër CEKAJ është telefonuar nga ky oficer policie, ku kanë komunikuar 2 minuta e 46 sekonda. Bisedë kjo e cila nuk është transkriptuar nga ana e organit të akuzës me qëllim siç është vepruar edhe në shumë prova të tjera... Më pas Donaldo është pyetur nga ana e Arbërit nëse kishin mbaruar punë dhe Donaldo i është përgjigjur që po presim të

- firmosin letrat e kontrollit këta të Narko Trafikut të cilët kishin bërë kontrollin e kontenierit, pasi kishin ikur pa firmosur.
- 12.86 Pra nga dinamika e komunikimit të drejtë midis Arbër ÇEKAJ dhe Donaldo LUSHAJ del shumë qartë që ata nuk kanë komunikuar të shqetësuar, por kanë komunikuar normalisht dhe Donaldo i është përgjigjur ineteresimit dhe pyetjeve të Arbërit në lidhje me procesin e punës që po ndodhte për kontejnerin.
- 12.87 Gjithashtu organi i akuzës nuk na tregon se cili ka qenë qëllimi që i pandehuri Arbër ÇEKAJ duhet të kryente një veprimtari të tillë. Kryerja e një veprimtarie të tillë nga ana e grupit të strukturuar kriminal bëhet vetëm me qëllim përfitimi kryerës i nevojshëm për konfigruimin e një bashkëpunimit të vecantë. Pra organi i akuzës duhet të argumentonte dhe të provonte njëkohsisht nëpërmjet provës konkrete qëllimin e përfitimit të të pandehurit Arbër ÇEKAJ pasi mendimi subjektiv i organit të akuzës nuk ka fuqin provuese dhe cilësinë e provës.
- 12.88 Në interpretim të nenit 152 të K.Pr.Penale, çmuarja e provave është procesi i përcaktimit të vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre, gjë që e bën gjykata. Bindja e brendshme, si e drejtë ekskluzive e atij që gjykon çështjen, formohet mbi bazë të provave të administruara në gjykim.
- 12.89 Duke i vlerësuar këto parime dhe kritere të të provuarit të përcaktuara në K.Pr.Penale në lidhje me faktet dhe rrethanat e çështjes objekt gjykimi, ku provat kryesore të pretenduara në lidhje me fajësinë ose jo të të pandehurit Arbër ÇEKAJ janë 1) *transkriptimi i bisedës midis Arbër ÇEKAJ dhe Donaldo LUSHAJ*, 2) *deklarimet e personave që kanë pasur dijeni*, 3) *largimi i të pandehurit jashtë shtetit*, 3) *pretendimi se i pandehuri ka qenë i përfshirë në një aktivitet të ngjashëm edhe në Ekuador*. Gjatë gjykimit nuk u paraqit asnjë provë direkte që të lidhë të pandehurin Arbër ÇEKAJ me këtë vepër, në gjykim nuk u paraqit asnjë provë shkresore (akt ekspertimi biologjik, kimike, etj) provë materiale (të përfituara nga aktet e ekspertimit dhe transkriptimet) apo dëshmitarë okularë që të provojë këtë akuzë ndaj të pandehurit. Në analizë të provave të paraqitura nga ana e organit të akuzës, çmojmë se niveli i shkallës së të provuarit të akuzës së “Trafikimit të narkotikëve” dhe “Grupi i strukturuar kriminal” ndaj të pandehurit është inekzistent....
- 12.90 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut e çmon mënyrën në të cilën trajtohen provat si një çështje të rëndësishme në marrjen e vendimit nëse një gjyq ka qenë i drejtë apo jo. (Çështja Van Mechelen dhe të tjerë kundër Vendeve të Ulëta, 18 mars 1977). Edhe më parë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë<sup>5</sup> është shprehur se: “Përcaktimi i vërtetësisë së provës që

<sup>5</sup> vendimin nr.25, datë 15.01.2003 i Kolegjit Penal i Gjykatës së Lartë.

*është vënë si kusht nga ligjvënësi për të patur një proces ligjor çmuarje të saj, nënkupton...verifikimi se ku konsiston lidhja e rrethanës apo objektit material konkret me objektin e të provuarit në çdo gjykim konkret, të cilin e përbëjnë përgjigjet që duhet t'u japë gjykata pyetjeve të tilla si: çfarë ka ndodhur, ku dhe kur ka ndodhur, me ç'mjet është kryer, si ka ndodhur, kush dhe pse e ka kryer veprën, përgjigje, të cilat duhet të përbëjnë shtratin mbi të cilin duhet ndërtuar pjesa arsytuese e çdo vendimi gjyqësor në procesin penal". Po kështu është shprehur se<sup>6</sup>: "Proçesi i të provuarit...është vërtetimi i fakteve nëpërmjet grumbullimit të provave të mjaftueshme për të bindur gjykatën lidhur me fajësinë e tij (të pandehurit)....".*

- 12.91 Në analizë të këtij vendimi të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë por edhe vendimeve të cituara më lartë, arrijmë në përfundimin ligjor se organi i akuzës **nuk mund ta bazojnë fajësinë e një personi duke u bazuar vetëm mbi një provë qoftë ajo edhe shkencore, por duhet të analizohet në raport me provat e tjera të administruara në gjykim.**
- 12.92 **A duhet të vërtetohen të gjitha veprat penale me prova direkte? Patjetër që veprat penale duhet të provohen me prova direkte sepse edhe konkluzioni përfundimtar ose fakti i konstatuar nga provat ndihmon në vërtetimin e objektivit përfundimtar.**
- 12.93 **Për të gjitha këto argumente që parashtruar çmojmë se nuk gjenden të konsumuara elementët e figurës së veprës penale "Trafikimi i narkotikëve" "Grupi i strukturuar kriminal", "Kryerja e veprave penale nga grupi i strukturuar kriminal", parashikuar nga nenet 283/a 333/a/2, 334/1, të Kodit Penal.**
- 12.94 **Prandaj përfundimisht i kërkojmë gjykatës që të vlerësoj pretendimin tonë të argumentuar teorikisht dhe ligjërisht mbështetur në rrethanat në të cilën është zhvilluar ngjarja dhe provat e administruara kërkojmë ndryshimin e vendimit Nr..., datë 15.9.2020 të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe deklarimin e pafajshëm për të pandehurit Arbër ÇEKAJ.**

PËR PALËN ANKUESE

Arbër ÇEKAJ

*Përfaqësuar me prokurë të posaçme nga*

**Prof. Dr. Maksim R. HAXHIA**

<sup>6</sup> Vendimi nr.205, datë 06.04.2005 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.